



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2019 – Numri: 68

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 13 maj 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 10.5.2019	Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019.....	5067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 10.5.2019	Për pezullimin e përkohshëm të fillimit të procedurave të prokurimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet kontraktore në varësi të tyre, për periudhën 1 deri 30 qershor 2019.....	5071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 10.5.2019	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	5072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 287, datë 10.5.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar.....	5072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 10.5.2019	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Dibër, për Njësinë Administrative Maqellarë, të pronave me nr. 112, “Shkolla 9-vjeçare Maqellarë”, nr. 128, “Shkolla fillore Kërçisht i Poshtëm”, dhe nr. 129, “Shkolla fillore Kërçisht i Epërm”.....	5084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 10.5.2019	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pasurisë me numër 33/76, zona kadastrale 8523, me sipërfaqe truall 7 726 m ² dhe sipërfaqe ndërtese 7 307 m ² , me vendndodhje në Elbasan.....	5088
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 10.5.2019	Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019–2020.....	5091

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 10.5.2019	Për miratimin e rekomandimeve prioritare për prokurorin e përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2019.....	5095
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 10.5.2019	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të pasurisë nr. 25/2, zona kadastrale 8525, Elbasan, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit”, të ndryshuar.....	5113
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 298, datë 10.5.2019	Për një shtesë fondi, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019.....	5121
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 10.5.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, të ndryshuar.....	5121
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 10.5.2019	Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, aplikuesit “Concord Investment” sh.p.k.	5124
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 10.5.2019	Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore.....	5124
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 10.5.2019	Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare.....	5128
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 10.5.2019	Për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut, të përkatësisë etnike shqiptare.....	5154



VENDIM
Nr. 283, datë 10.5.2019

**PËR MARRJEN E MASAVE DHE
MONITORIMIN E VEPRIMTARISË,
SJELLJES APO PËRDORIMIT TË
BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE
DHE LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS
SHTETËRORE, GJATË PROCESIT
ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET
VENDORE PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 7, 63, pika 4, 78, pika 5, e 88, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektorale, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

2. Në kuptim të këtij vendimi:

- Administratë shtetërore është administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 4, të këtij ligji, ndaj të cilëve ky vendim do të zbatohet;

- Punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin

4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë civilë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;

- Funksionarë kabineti janë nëpunës të administratës, sipas përkufizimit të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ndaj të cilëve nuk zbatohet ky vendim;

- Punonjës policie, punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjerë rregullohen me ligje të posaçme, janë punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

4. Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

5. Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë lejen me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale si pjesë e shërbimit civil.

6. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohej çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.



7. Nëpunësit civil, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, sipas pikës 4, të këtij vendimi, në kuptim të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, i ndalohet:

a) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat;

b) të manifestojë me pankarta, parulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;

c) të jetë protagonist në aktivitetet / veprimtaritë politike apo të kandidatëve.

8. Punonjësit të Policisë së Shtetit i ndalohet:

a) të jetë anëtar i një partie ose organizate politike;

b) të mbështetë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtari partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht ose financiarisht.

9. Punonjësit të Gardës së Republikës i ndalohet:

a) të sillet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës;

b) anëtarësimi e pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike apo të kandidatëve.

10. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i ndalohet:

a) të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit;

b) anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike apo të kandidatëve;

c) të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike ose kundër kandidatëve në zgjedhje.

11. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura i ndalohet:

a) të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik;

b) të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre apo nga kandidatët.

12. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare a njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

13. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre të organizojnë menjëherë punën dhe të

marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e administratës shtetërore, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore, të çdo niveli, për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019.

14. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre të kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve nën varësinë e tyre, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

Për efekt të zbatimit të kësaj pike, përveç masave të tjera, titullarët janë të detyruar që të publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare të internetit, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

15. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre verifikojnë dhe analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale.

16. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të garantuar mospërdorimin e:

a) burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;



b) fondeve të institucioneve për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;

c) mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;

ç) zhvillimit të fushatës zgjedhore në institucionet publike apo realizimit të propagandës politike në to;

d) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;

dh) detyruar, në fushatë zgjedhore, të administratës së institucionit brenda ose jashtë orarit të punës, si dhe të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar brenda ose jashtë orarit mësimor.

17. Në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 63, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, titullarët e ministrive ose drejtuesit e institucioneve të varësisë marrin masa për pezullimin nga detyra të nëpunësve civilë të institucioneve të tyre, të cilët janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019. Për nëpunësit e tjerë, marrëdhënia e punës të të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, merren masa, sipas rastit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës apo pezullimin nga detyra në rastet kur rezultojnë që janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019.

18. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit të administratës shtetërore, ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara në zgjedhje apo të kandidatëve.

Bën përjashtim nga ky ndalim përdorimi i automjeteve të Gardës së Republikës dhe të Policisë së Shtetit, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale.

Strukturat e Policisë së Shtetit, kur konstatojnë përdorimin e automjeteve shtetërore të institucioneve të pushtetit qendror e vendor, për veprimtari të fushatës zgjedhore, të bëjnë bllokimin e tyre dhe, menjëherë, të njoftojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe titullarin e institucionit në përdorim të të cilit është

automjeti. Automjeti të zhblokohet pas ekzekutimit të masës së marrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor. Në këtë rast, struktura e Policisë së Shtetit bën referim në organet kompetente për përdorimin e të mirave publike në favor të subjekteve zgjedhore.

19. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në zbatim të detyrimeve të tij për organizimin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, të marrë masa dhe t'i parashtrojë Kryeministrit mospërfshirjen në rendin e ditës të projektvendimeve në lidhje me koncesione, kontrata apo angazhime të tilla politike, ekonomike apo sociale që nuk vijnë në zbatim të programit analitik të çdo ministrie/institucioni, siç është miratuar nga Këshilli i Ministrave.

20. Ministrinë dhe institucionet e varësisë, me qëllim shmangien e keqpërdorimit dhe keqinterpretimit të aktiviteteve institucionale me fushatën elektorale, të publikojnë në faqen e tyre zyrtare:

a) deri në datën 30 qershor 2019, të dhënat për aktivitetet publike, të programuara për muajin qershor, që kanë lidhje me veprimtarinë e institucionit;

b) listën e projekteve të nisura prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, në ushtrim të punës dhe të veprimtarisë së institucionit, të cilat janë në proces përfundimi, si dhe të gjitha procedurat publike konkurruese të realizuara gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit.

21. Ministrinë dhe institucionet/organet e varësisë t'u krijojnë vëzhguesve dhe shoqatave të regjistruara në KQZ, si vëzhguese të procesit zgjedhor, akses të plotë për të marrë informacion në lidhje me detyrimet ligjore të administratës publike në procesin zgjedhor. Ministrinë dhe institucionet/organet e varësisë informojnë publikun në mënyrë të vijueshme për monitorimin e realizuar në kuadër të këtij vendimi.

22. Për koordinimin e procesit të monitorimit, sipas këtij vendimi, krijohet Task-Forca që drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje:

- ministrin e Brendshëm;
- ministrin e Mbrojtjes;
- ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;



- ministrin e Drejtësisë;
- ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
- drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
- drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- drejtorin e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

Në mbledhjet e Task-Forcës ftohen të marrin pjesë:

- komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- Avokati i Popullit;
- një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;
- një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në mbledhjet e Task-Forcës ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga organizma ndërkombëtare, në raste kur Task-Forca e gjykon të nevojshme marrjen e asistencës teknike lidhur me çështje të procesit zgjedhor.

23. Task-Forca mbështetet nga një sekretariat teknik i përbërë, përkatësisht, nga një nëpunës i kabinetit të Kryeministrit, kabinetit të Zëvendëskryeministrit, aparatit të Këshillit të Ministrave.

Çdo institucion i përfaqësuar me anëtarë në përbërje të Task-Forcës cakton një punonjës kontakti që asiston sekretariatit teknik gjatë veprimtarisë së tij.

Sekretariati teknik përpunon të gjithë informacionin e mbledhur dhe ia referon Task-Forcës.

24. Task-Forca mblidhet me njoftim nga kryetari periodikisht të paktën një herë në javë ose sa herë që vlerësohet e nevojshme prej tij ose të paktën prej 2 anëtarëve. Në mbledhjet e saj Task-Forca, sipas rastit, cakton detyra më të detajuara për secilin anëtar, si dhe, nëse e konsideron të nevojshme, miraton një plan veprimi apo masash për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.

Çdo institucion shtetëror dhe institucion i pavarur, pjesë e Task-Forcës, raporton, me shkrim, periodikisht lidhur me zbatimin e masave

e të detyrave të ngarkuara, si dhe për problematikat e hasura gjatë procesit të monitorimit sipas këtij vendimi.

25. Ngarkohen Policia e Shtetit dhe/ose Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave t'i raportojnë, me shkrim, Task-Forcës çdo rast kur konstatojnë përdorim në procesin zgjedhor të mjeteve financiare të krijuara nga veprimtari të paligjshme.

26. Task-Forca, brenda sferës së veprimtarisë së saj, kur e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve informacion, me shkrim, për veprimtari në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, për të cilat ky i fundit merr dijeni nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

27. Task-Forca, nëpërmjet zyrës së shtypit të Kryeministrit, komunikon me publikun për çështjet e shqyrtuara dhe masat e marra.

28. Task-Forca të ushtrojë funksionet dhe të përmbushë detyrat e sipërpërmendura deri në përfundimin e procesit zgjedhor.

29. Titullarët e ministrive urdhërojnë ngritjen e grupeve të monitorimit/inspektimit për mënyrën e zbatimit të këtij vendimi dhe në funksion të informimit të Task-Forcës, duke përcaktuar edhe detyrat konkrete dhe veprimtarinë që do të mbikëqyrin këto grupe.

30. Task-Forca, në bashkëpunim me titullarët e ministrive dhe grupet e monitorimit, të përmbushë detyrat, si më poshtë vijon:

a) monitorimin e sjelljes dhe të veprimtarisë së administratës shtetërore, sipas këtij vendimi;

b) monitorimin e administratës shtetërore në drejtim të përdorimit të autoritetit shtetëror vetëm në përputhje me ligjin duke mos lejuar përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të shtetit gjatë procesit zgjedhor si dhe duke mos lejuar kryerjen e veprimeve dhe/ose dhënien e premtimeve, favoreve apo moscenimin e të drejtave të shtetasve, si mekanizëm për favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik apo kandidati;

c) monitorimin e procesit zgjedhor me qëllim konstatimin dhe raportimin e përdorimit gjatë fushatës dhe procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme;

ç) monitorimin e procesit zgjedhor, përfshirë ditën e votimit, në funksion të mospërfshirjes në



të të zyrarëve apo personave të tjerë që ndodhen në institucione shtetërore, përfshirë personat e burgosur, dhe marrjen e masave për ndëshkimin e atyre zyrarëve që veprojnë në kundërshtim me ligjin. Pjesë e kësaj detyre është edhe monitorimi i lëvizjes së nëpunësve të lartë dhe të mesëm shtetërorë në qendër dhe qarqe apo bashki gjatë procesit zgjedhor;

d) monitorimin e përditësimit dhe ndjekjen e problematikave me listat e zgjedhësve;

dh) monitorimin e zbatimit të masave për pezullimin e iniciativave për kontrata të përkohshme në nivel qendror e vendor;

e) monitorimin e përditësimit të akteve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;

ë) njoftimin apo kryerjen e kallëzimit penal në Prokurorinë e Përgjithshme për raste të marrjes/vënies në dijeni për kryerjen e veprave penale në fushën zgjedhore;

f) njoftimin e Avokatit të Popullit kur merr apo vihet në dijeni për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë procesit zgjedhor;

g) njoftimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kur merr dijeni apo vihet në dijeni për problematika të procesit zgjedhor;

gj) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Policinë e Shtetit në funksion të marrjes së masave të menjëhershme në përputhje me ligjin kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarive të kundërligjshme gjatë procesit zgjedhor;

h) çdo detyrë tjetër në funksion të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi.

31. Moszbatimi i rregullave dhe i detyrimeve të parashikuara në këtë vendim passjell përgjegjësi disiplinore dhe ligjore, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

32. Ngarkohen anëtarët e Task-Forcës, ministrat, titullarët e institucioneve të administratës shtetërore, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 284, datë 10.5.2019

**PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË
FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT NGA NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE DHE
AUTORITETET KONTRAKTORE NË
VARËSI TË TYRE, PËR PERIUDHËN
1 DERI 30 QERSHOR 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pezullimin e përkohshëm të fillimit të procedurave të prokurimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet kontraktore në varësi të tyre, për periudhën 1 deri 30 qershor 2019.

Përfshihen nga ky rregull:

- prokurimet me vlerë të vogël;
- procedurat e prokurimit që kanë si objekt produktet ushqimore.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e vetëqeverisjes vendore, institucionet në varësi të tyre dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 285, datë 10.5.2019

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË (“LISTA E OKB-SË”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

1: MOHAMMED 2: MASOOD 3: AZHAR 4: ALVI

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 287, datë 10.5.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 55, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE, UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 62, 97 e 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 7, pas nënndarjes 7.2. shtohet nënndarja 7.3. me përmbajtjen, si më poshtë vijon:



“7.3. Funkcionet, që, për arsye pune dhe shërbimi, gjatë orarit zyrtar mbajnë veshje civile.”.

2. Në albumin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) në lidhjen nr. 1, fig. nr. 1, faqe nr. 7, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

b) në lidhjen nr. 1, fig. nr. 1/1, faqe nr. 7/1, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

c) në lidhjen nr. 1, fig. nr. 1/2, faqe nr. 7/2, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

ç) në lidhjen nr. 3, pas faqes 21 shtohet faqja 21/1, me artikujt “Këpucë ceremoniale për meshkuj” dhe “Këpucë ceremoniale për femra”, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;

d) në lidhjen nr. 3, faqe 22, fjalët “Këpucë me qafa dimërore për femra dhe meshkuj”, zëvendësohen me fjalët “Këpucë dimërore për femra dhe meshkuj” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

dh) në lidhjen nr. 3, faqe 22, për uniformën bazë, shtohet artikulli “Pulovër me jakë gjysmë golf”, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;

e) në lidhjen nr. 3, faqe 25, për uniformën bazë, shtohet artikulli “Këmishë blu me mëngë të shkurtra”, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;

ë) në lidhjen nr. 3, faqe 25, fjalët “Këpucë gjysma verore për meshkuj” zëvendësohen me “Këpucë verore për meshkuj” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

f) në lidhjen nr. 3, faqe 25, fjalët “Këpucë gjysma verore për femra” zëvendësohen me “Këpucë verore për femra” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

g) në lidhjen nr. 3, faqe 25, fjalët “Këpucë gjysma me qafa shërbimi” zëvendësohen me “Këpucë taktike dimërore” dhe modeli përkatës

zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

gj) në lidhjen nr. 3, faqe 30, fjalët “Këpucë tip atlete”, zëvendësohen me “Këpucë taktike për patrullë në plazhe” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

h) në lidhjen nr. 3, faqet 25 dhe 38, fjalët “Bluzë pambuku me dy kopsa” zëvendësohen me “Bluzë polo me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

i) në lidhjen nr. 3, faqe 26, fjala “Xhaketë”, te kostumi i dokut, zëvendësohet me “Këmishë blu me mëngë të gjata” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

j) në lidhjen nr. 3, faqet 27, 31 dhe 32, modelet e uniformës dimërore dhe asaj verore zëvendësohen sipas modeleve që i bashkëlidhen kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi. Për këto modele shtohen jelekët me vizibilitet të lartë, me ngjyrë të kuqe dhe blu të çelët, dhe për uniformën verore shtohet “Bluza polo me mëngë të gjata”, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

k) në lidhjen nr. 3, faqet 27 dhe 31, për uniformën verore shtohet artikulli “Këpuce taktike verore për motoçiklistët”, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;

l) në lidhjen nr. 3, faqe 28, fjalët “Jelek fosforeshent” zëvendësohen me “Jelek me vizibilitet të lartë” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

ll) në lidhjen nr. 3, faqe 39, fjalët “Jelek shpëtimi fosforeshent” zëvendësohen me “Jelek shpëtimi” dhe modeli përkatës zëvendësohet me modelin që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

m) në lidhjen nr. 3, faqe 42, modeli i rripit ceremonial zëvendësohet sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

n) në lidhjen nr. 4, modeli i përcaktuar në faqen 45 për shenjën e mbiemrit dhe numrin e identifikimit zëvendësohet me modelin me të

njëtin numër faqeje, që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi;

nj) në lidhjen nr. 4, fig. nr. 1, faqe nr. 53, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet kësaj lidhjeje, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.





III. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA nr. 1

Fotografitë e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si shembull ilustrues referencë.

a) Lidhja nr. 1 fig nr. 1 faqe 7	
GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI INSPEKTOR	
	
GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE INSPEKTOR	
	
GRADË E VOGËL GJOKSI INSPEKTOR	
	
b) Lidhja 1 fig nr. 1/1 faqe 7/1	
GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI INSPEKTOR I DYTË	
	
GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALI INSPEKTOR I DYTË	




GRADË E VOGËL GJOKSI INSPEKTOR I DYTË



c) Lidhja 1 fig nr. 1/2 faqe 7/2

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI INSPEKTOR I PARË



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALI INSPEKTOR I PARË



GRADË E VOGËL GJOKSI INSPEKTOR I PARË



d) Lidhja nr. 3 faqe 21/1

Këpucë ceremoniale për meshkuj





Këpucë ceremoniale për femra



e) Lidhja nr. 3 faqe 22

Këpucë dimërore për femra dhe meshkuj



f) Lidhja nr. 3 faqe 22

Pulovër me jakë gjysëm golf

Për femra



Për meshkuj



g) Lidhja nr. 3 faqe 25

Këmishë blu më mëngë të shkurtra



h) Lidhja nr. 3 faqe 25

Këpucë verore për meshkuj



i) Lidhja nr. 3 faqe 25

Këpucë verore për femra





j) Lidhja nr. 3 faqe 25

Këpuca taktike dimërore



k) Lidhja nr. 3 faqe 30

Këpuca taktike për patrullë në plazhe



l) Lidhja nr. 3 faqe 25 dhe 38

Bluzë polo me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit



m) Lidhja nr. 3 faqe 26

Këmishë blu me mëngë të gjata



n) Lidhja nr. 3 faqe 27

Kostumi dimëror për Patrullën e Policisë Rrugore dhe Motoçiklistët



Jeleku i faqes 28



Uniforma verore



Bluzë polo me mëngë të gjata



Lidhja nr. 3 faqe 31

Kostumi dimëror për Patrullën me motoçikleta



Uniforma verore

Bluzë polo me mëngë të gjata



Lidhja nr. 3 faqe 32

Kostumi dimëror për Patrullën e Përgjithshme



Uniforma verore

Bluzë polo me mëngë të gjata



o) Lidhja nr. 3 faqe 27 dhe 31

Këpuce taktike verore për motociklistët.



p) Lidhja nr. 3 faqe 28

Jelek me vizibilitet të lartë




q) Lidhja nr. 3 faqe 39

Jelek shpëtimi



r) Lidhja nr. 3 faqe 42


Rrip ceremonial



s) Lidhja nr. 4 faqe 45


SHENJA E MBIEMRIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT




t) Lidhja nr. 4 fig nr. 1 faqe 53

SHENJË PËR KURSANTË / STUDENTË



SHENJË CEREMONIALI PËR KURSANTË / STUDENTË



SHENJË GJOKSI PËR KURSANTË / STUDENTË



VENDIM

Nr. 288, datë 10.5.2019

VENDOSI:

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DIBËR, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE MAQELLARË, TË PRONAVE ME NR. 112, “SHKOLLA 9-VJEÇARE MAQELLARË”, NR. 128, “SHKOLLA FILLORE KËRÇISHT I POSHTËM”, DHE NR. 129, “SHKOLLA FILLORE KËRÇISHT I EPËRM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “b”, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme, publike, të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Dibër, për njësinë administrative Maqellarë, të pronave me nr.112, “Shkolla 9-vjeçare Maqellarë”, nr. 128, “Shkolla fillore Kërçisht i Poshtëm”, dhe nr.129, “Shkolla fillore Kërçisht i Epërm”, sipas formularëve, plan-rilevimit dhe lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryetari i Bashkisë Dibër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



PLAN RILEVIMI

KUFIZIMET			IDENTIFIKIMI I PASURISË	
<u>VERI</u>	- NR.PAS	- <u>246, 247</u> <u>248/2</u>	ZONA KADASTRALE	<u>2592</u>
<u>JUG</u>	- NR.PAS	- <u>238, 239, 240</u>	NR. I PASURISË	<u>242</u> ND.VOL <u> </u> FQ <u> </u>
<u>LINDJE</u>	- NR.PAS	- <u>243, 106/5</u>	INDEKSI I HARTËS (<u> </u>)	
<u>PERËNDIM</u>	- NR.PAS	- <u>241, 257</u>	SHKALLA	<u>1:1000</u>
			ADRESA E PASURISË : RRETHI : <u>DIBËR</u>	
			Q/IF - <u>Magellare</u> , RR/L - " <u> </u> "	
			PRONARI: <u> </u>	
			SIPËRFAQJA E PARCELËS = <u>1968 M²</u>	



<p>PËRGATITI</p> <p><i>Lep. Landiu HOXHA</i></p> <p><i>[Signature]</i></p>	<p>MIRATOHET:</p> <p>KRYETARI I BASHKISË DIBËR</p> <p><i>MUHAMMED RAMA</i></p> <p><i>[Signature]</i></p>
---	---



Bashkia Dibër, Njësia Administrative Maqellarë

Lidhje 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
112, 128, 129	Prona që përdoren në fushën e arsimit para universitar.	Në pronësi Te pronë nr. 112 kalon në pronësi vetëm sipërfaqja 1968 m ² , për pasurinë nr. 242, ndodhur në zonën kadastrale 2592, sipas planit rievimit bashkëlidhur këtij vendimi.

1. FOKUMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHITETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Komuna : Maqellare		Identifikoi: Nuredin Tafsiu (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Supervizoi: Bujar Spahiu (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Aprovoi: Bardhyl Agolli (Kryetar Komune) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, lei, firma, vula)		C		
Fusha e përdorimit të Pronës: Arsim		B		B		B		C		
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti për pronën Status juridik i përdorimit	Te cilave lera (Shënimet të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
111	K-34-89 64-C	274	Truall Ndertese	Shkollë e mesme Fshati Maqellare Komuna Maqellare	4500	600	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoria Arsimore Peshkopi	*
112	K-34-89 64-D	241,242, 243,245	Truall Ndertese	Shkollë e vjetër 5-vjeçare Fshati Maqellare Komuna Maqellare	4520	818	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoria Arsimore Peshkopi	Nje pjese e truallit eshte i zane me 6 objekte private lokale biznesi
113	K-34-89 64-D	270	Truall Ndertese	Qendra ekonomike Fshati Maqellare Komuna Maqellare	660	243	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoria Arsimore Peshkopi	
114	K-34-89 80-D	45	Truall Ndertese	Shkollë e 5-vjeçare Fshati Maqellare Komuna Maqellare	2600	500	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoria Arsimore Peshkopi	
115	K-34-89 79-B	255	Truall Ndertese	Shkollë fillore Fshati Burim Komuna Maqellare	1100	200	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoria Arsimore Peshkopi	



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
124	K-34-89 32-C		Truall Ndertese	Shkollle fillore Fshati Erebare Komuna Maqellare	900	220	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
125	K-34-89 48-A		Truall Ndertese	Shkollle e vjeter Fshati Dovalan Komuna Maqellare	300		Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
126	K-34-89 64-B		Truall Ndertese	Kopesht Fshati Katund I Vogel Komuna Maqellare	2100	180	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
127	K-34-89 47-C		Truall Ndertese	Shkollle fillore Fshati Gradec Komuna Maqellare	300	100	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
128	K-34-89 49-D		Truall Ndertese	Shkollle fillore Fshati Kercisht I Poshtem Komuna Maqellare	1950	230	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
129	K-34-89 49-C		Truall Ndertese	Shkollle fillore Fshati Kercisht I Eperem Komuna Maqellare	700	130	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
130	K-34-89 79-B		Truall Ndertese	Shkollle fillore Fshati Vojnike Komuna Maqellare	1800	320	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi
131	K-34-89 79-B		Truall Ndertese	Shkollle e vjeter Fshati Burim Komuna Maqellare	750	130	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Shkences	Drejtoria Arsimore Peshkopi



VENDIM
Nr. 289, datë 10.5.2019

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
 ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
 FINANCAVE DHE EKONOMISË TË
 PASURISË ME NUMËR 33/76, ZONA
 KADASTRALE 8523, ME SIPËRFAQE
 TRUALLI 7 726 m² DHE SIPËRFAQE
 NDËRTESE 7 307 m², ME
 VENDNDODHJE NË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pasurisë me numër 33/76, zona kadastrale 8523, me sipërfaqe trualli 7 726 m² (shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) dhe sipërfaqe ndërtese 7 307 m² (shtatë mijë e treqind e shtatë), pronë shtet, me vendndodhje në Elbasan, sipas kartelës së pasurisë dhe hartës treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Miruar nga V.K.M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISË SE PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË

Zona Kadastrale: 8523 NR. I PASURISË: 33/76 Viti në: Vol. _____ Fq. _____

Indeksi i Qarës: EL: R-3

Adresa e pasurisë: Rrethi ELBASAN QY ELBASAN

Ref/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TË PASURISË

Lloji i Pasurisë: TERRA Brenda V.K.N.: Jo ---> Po, Ref: _____

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtese	Për pjesën e përbashkët:
1. <u>7726</u> m ²	1. <u>7726</u> m ²	1. <u>7307</u> m ²	PALLAT
Ref. <u>005506</u>	Ref. <u>005506</u>	Ref. <u>005506</u>	Kuota e Pjesëmarrjes: _____
2. _____ m ²	2. _____ m ²	2. _____ m ²	Nr. i Pasurisë (Pallat): _____
Ref. _____	Ref. _____	Ref. _____	Vol. _____ Fq. _____
3. _____ m ²	3. _____ m ²	3. _____ m ²	
Ref. _____	Ref. _____	Ref. _____	
4. _____ m ²	4. _____ m ²	4. _____ m ²	
Ref. _____	Ref. _____	Ref. _____	

C - SEKSIONI I PRONËSISË

Nr. Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
<u>05506</u>	<u>14.12.2006</u>	<u>SHTET</u>			<u>ELBASAN</u>			<u>NA PAS</u>	

Shënime: A - lloji i pasurisë; B - lloji i pronarisë; C - lloji i pronarisë; D - lloji i pronarisë; E - lloji i pronarisë; F - lloji i pronarisë; G - lloji i pronarisë; H - lloji i pronarisë; I - lloji i pronarisë; J - lloji i pronarisë; K - lloji i pronarisë; L - lloji i pronarisë; M - lloji i pronarisë; N - lloji i pronarisë; O - lloji i pronarisë; P - lloji i pronarisë; Q - lloji i pronarisë; R - lloji i pronarisë; S - lloji i pronarisë; T - lloji i pronarisë; U - lloji i pronarisë; V - lloji i pronarisë; W - lloji i pronarisë; X - lloji i pronarisë; Y - lloji i pronarisë; Z - lloji i pronarisë.

239
26.03.19D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma


E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)





VENDIM

Nr. 295, datë 10.5.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2019–2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 74, dhe të pikës 2, të nenit 76, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.

2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, nota mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019–2020, të jetë nota 6.5 (gjashtë pikë pesë).

3. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016–2017 dhe në vijim.

4. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:

a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

5. Për kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë, për vitin akademik 2019–2020, nota mesatare e përllogaritur sipas këtij vendimi të jetë nota 7.5 (shtatë pikë pesë). Nota mesatare e kandidatëve që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë përllogaritet sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi.

6. Programet e studimit të fushës së mësuesisë përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi.

8. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

9. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



SHTOJCA 1

Nr.	INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti i Tiranës	Biologji	7.5
2		Filozofi	7.5
3		Fizikë	7.5
4		Gjeografi	7.5
5		Gjuhë angleze	7.5
6		Gjuhë angleze (Sarandë)	7.5
7		Gjuhë frënge	7.5
8		Gjuhë gjermane	7.5
9		Gjuhë greke	7.5
10		Gjuhë italiane	7.5
11		Gjuhë–Letërsi	7.5
12		Gjuhë ruse	7.5
13		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë–letërsi dhe Qytetërim hispanik	7.5
14		Gjuhë turke	7.5
15		Histori	7.5
16		Informatikë	7.5
17		Kimi	7.5
18		Matematikë	7.5
19		Psikologji	7.5
20		Sociologji	7.5
Nr.	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Edukim qytetar	7.5
3		Filozofi - Sociologji	7.5
4		Gjeografi dhe Gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë – Letërsi	7.5
6		Gjuhë angleze	7.5
7		Gjuhë frënge	7.5
8		Gjuhë gjermane	7.5
9		Gjuhë italiane	7.5
10		Histori - Gjeografi	7.5
11		Histori dhe Gjuhë gjermane	7.5
12		Matematikë informatike	7.5
13		Matematikë - Fizikë	7.5
14		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
15		Mësuesi për arsim fillor	7.5
16	Psikologji	7.5	
Nr.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Gjermanisht - Anglisht	7.5



2		Gjuhë Angleze	7.5
3		Gjuhë - Letërsi - Anglisht	7.5
4		Histori	7.5
5		Informatikë - Anglisht	7.5
6		Matematikë - Informatikë	7.5
7		Mësuesi për arsim fillor	7.5
8		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
9		Psikologji - Sociologji	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	Biologji - Kimi	7.5
2		Gjuhë - Letërsi shqipe	7.5
3		Gjuhë - Letërsi angleze	7.5
4		Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim grek	7.5
5		Gjuhë - Letërsi italiane	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Matematikë - Informatikë	7.5
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	Biologji - Kimi	7.5
2		Filozofi - Sociologji	7.5
3		Gjuhë angleze	7.5
4		Gjuhë dhe kulturë frënge	7.5
5		Gjuhë - Letërsi	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Matematikë - Fizikë	7.5
8		Matematikë - Informatikë	7.5
9		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
10		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	
1	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	Biologji	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjuhë angleze	7.5
4		Gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë shqipe dhe Letërsi	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Informatikë	7.5
8		Kimi	7.5
9		Matematikë	7.5
10		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
11		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
12		Pedagogji e specializuar	7.5



Nr.	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjeografi	7.5
4		Gjuhë - Letërsi	7.5
5		Gjuhë angleze	7.5
6		Gjuhë frënge	7.5
7		Gjuhë gjermane	7.5
8		Gjuhë italiane	7.5
9		Histori	7.5
10		Informatikë	7.5
11		Matematikë	7.5
12		Mësuesi arsimit fillor	7.5
13		Mësuesi arsimit parashkollor	7.5
14		Psikologji	7.5
Nr.	Kolegji universitar “Bedër”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5
2		Gjuhë dhe letërsi angleze	7.5
3		Psikologji këshillimi dhe Pedagogji	7.5
Nr.	Kolegji universitar “Wisdom”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.	SHLUJ, Universiteti “Marin Barleti”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.	Universiteti European i Tiranës	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
2		Sociologji - Antropologji sociale	7.5
3		Filozofi	7.5
4		Histori	7.5
5		Letërsi	7.5
6		Linguistikë	7.5
7		Arsim parashkollor	7.5
Nr.	Universiteti i New York-ut në Tiranë	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.	Universiteti privat “Albanian University”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Anglisht	7.5
2		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
3		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
4		Psikologji e përgjithshme	7.5
Nr.	Kolegji universitar “Logos”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
2		Gjuhë dhe Civilizim grek	7.5



VENDIM
Nr. 296, datë 10.5.2019

PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE
PRIORITARE PËR PROKURORIN E
PËRGJITHSHËM, NË LUFTËN
KUNDËR KRIMINALITETIT, PËR
VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t’i përcjellë menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare, si dhe t’ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REKOMANDIME PRIORITARE
PËR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM NË
LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR
VITIN 2019

Tiranë, mars 2019

Në zbatim të nenit 103, të ligjit nr. 97, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Ministrave, miraton dhe i përcjell

Prokurorit të Përgjithshëm, Rekomandimet Prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura Rekomandimet e Këshillit të Ministrave, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.

Këto rekomandime prioritare i përcillen organit të prokurorisë në ushtrim të përgjegjësisë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve. Rekomandimet kanë për qëllim dhe synojnë garantimin e funksionimit efektiv të organit të prokurorisë, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar, dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut.

Përgatitja e rekomandimeve prioritare, është mbështetur në Programin Qeverisës 2017–2021¹, analizën e dokumenteve strategjike qeveritarë si Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021², Plani i Veprimit 2018–2020 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit³ Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Planit të Veprimit 2018–2021⁴, Plani Kombëtar kundër Kanabisit⁵ raportet e organizmave ndërkombëtarë joqeveritarë⁶ që lidhen me monitorime për çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike.

Gjithashtu, në përgatitjen e këtyre rekomandimeve është shfrytëzuar edhe kontributi i paraqitur nga strukturat e pushtetit ekzekutiv, të cilat kanë në përbërje të tyre personel, që me ligj i është njohur cilësia e

¹ Publikuar në faqen zyrtare: <https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>

² Miratuar nga Këshilli i Ministrave, në datë 10.4.2019

³ Miratuar me VKM-në nr. 241, datë 20.4.2018

⁴ Miratuar me VKM nr. 541, datë 19.9.2018.

⁵ Ndryshuar me VKM nr. 313, datë 31.5.2018.

⁶ Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit “International Narcotics Control Strategy Report- Money Laundering and Financial Crimes”, mars 2019 dhe “Country Reports on Human Rights Practices for 2018”; Indeksi i sundit të ligjit 2019 i World Justice Project; dhe Indeksi i perceptimit të korrupsionit 2018” i Transparency International.



policisë gjyqësore, si dhe statistikat e dërguara nga organi i prokurorisë në zbatim të nenit 38, germa “h”, të ligjit nr. 97/2016⁷.

Referuar nenit 6, pika 32, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ndryshuar me ligjin nr. 40/2017, Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion mbi zbatimin në vijimësi të Rekomandimeve Prioritare “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018”, i cili gjithashtu është konsideruar në përgatitjen e këtyre rekomandimeve⁸.

Reforma që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë në sistemin e drejtësisë ka objektiv final krijimin e një sistemi drejtësie të aftë të sigurojë garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit, të respektojë parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, të kontribuojë në administrimin e drejtësisë penale, të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive dhe të drejtë, si dhe të implementojë legjislacionin e BE-së dhe të pasqyrojë standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Implementimi i plotë i reformës në drejtësi synon forcimin e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor, si garanci për një qeverisje funksionale dhe të përgjegjshme, si një kontratë e ligjshme, e monitorueshme dhe e kontrollueshme mes të zgjedhurve dhe qytetarëve të lirë.

Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor⁹ dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë¹⁰ në muajin dhjetor 2018, si dy nga shtyllat kryesore të sistemit gjyqësor, shënoi një hap më tej drejtë

zbatimit me sukses të reformës në drejtësi, pasi tashmë sistemi i drejtësisë do të qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efciencës. Ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë i hap rrugën krijimit të Strukturës së Posaçme Antikorrupsion¹¹, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm të Përhershëm¹², institucione këto shumë të rëndësishme në funksionimin e Drejtësisë së Reformuar.

Zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹³ si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, që pritet të kryhet brenda vitit 2019, do të plotësojë kuadrin institucional të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë si mekanizma që do të garantojnë edhe ndëshkimin e zyrtarëve të lartë të përfshirë në çështje korrupsioni do të jetë një hap shumë i rëndësishëm që do të ndihmojë në rifitimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe do të shënojë një gur themeli në luftën kundër korrupsionit.

Qeveria Shqiptare, ka dhënë dhe do të vijojë të jap gjithë mbështetjen e nevojshme infrastrukturore dhe financiare për funksionimin optimal të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, si dhe do të vazhdojë të japë mbështetjen maksimale organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si një garanci për ndërtimin e një sistemi drejtësie siç qytetarët shqiptarë e meritojnë – të drejtë, të pavarur dhe të denjë për një shtet evropian.

Në funksion të realizimit të këtij synimi Qeveria mbështet dhe kërkon angazhimin maksimal të institucioneve ligjzbatuese, në marrjen e masave për luftën kundër korrupsionit,

⁷ Me shkresën e tyre nr. 750/1 prot., datë 13.3.2019, regjistruar me tonën me nr. 2441 prot., datë 15.3.2019.

⁸ Ministria e Drejtësisë me shkresat e saj nr. nr. 9443 prot., datë 14.9.2018 dhe nr. 9443/3, datë 31.12.2018 i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të Rekomandimeve të vitit 2018. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 9443/1, datë 30.10.2018 dhe nr. 1465/1 datë 29.3.2019.

⁹ Vendimi nr. 4, datë 20.12.2018 “Mbi deklarimin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

¹⁰ Vendimi nr. 1, datë 19.12.2018 “Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

¹¹ Me vendimin nr. 10/1, datë 7.1.2019, KLP-ja shpalli fillimin e procedurave për shpalljen e vendeve vakante për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme. Me vendimin nr. 57 datë 5.4.2019 ka miratuar listën paraprake të 25 kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore që do të vazhdojnë garën e mëtejshme për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme.

¹² KLP me vendimin nr. 50, datë 19.3.2019 ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe përzgjedhjen e kandidatëve për prokuror të përgjithshëm” dhe në datën 29.3.2019 ka hapur garën për kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm.

¹³ Këshilli i Emërimeve ka shpallur thirrjen për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe listën e kandidatëve të paraqitur për këtë pozicion.



goditjen e krimit të organizuar në të gjitha format e tij, intesifikimin e luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, në respekt të plotë të lirive dhe të drejtave të individit, barazinë e shtetasve përpara ligjit, dhe angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave që duhen ndjekur nga organi i prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019 jepen në këto drejtime:

Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër krimit të organizuar

Respektimi i të drejtave të njeriut

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit përfaqëson një ndër sfidat kryesore për progresin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Krijimi i një historiku solid me hetime, ndjekje penale dhe dënime për korrupsion, sidomos në nivele të larta, është një ndër kushtet e vendosura nga Bashkimi Evropian për avancimin e Shqipërisë në rrugën e integritetit.

Qeveria Shqiptare gjatë vitit 2018 ka rritur fokusin e saj në luftën kundër korrupsionit, duke miratuar planin e veprimit 2018–2020¹⁴ në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015–2020, i cili parashikon ngritjen e Krijimit të Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, për periudhën 2015–2020, si dhe Task Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion që kryesohet nga Ministri i Drejtësisë.

Në kuadër të realizimit të këtij objekti është e rëndësishme që insitucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit i Marsit 2018¹⁵ midis të tjerave ka përmendur se: ...Ligji parashikon sanksione penale për korrupsionin e zyrtarëve publikë, por mungesa e zbatimit efektiv të ligjit ka pasqyellë pandëshkueshmërinë e zyrtarëve të përfshirë në veprime korruptive.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike”¹⁶ për vitin 2018, në të dy volumet e tij, midis të tjerave ka përmendur se: *Shqipëria duhet të zbatojë efektivisht ligjet dhe të forcojë kapacitetin e policisë dhe prokurorisë, duke u fokusuar në korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimin ekonomik. Qeveria ka ndërmarrë hapa për luftën e korrupsionit të zyrtarëve të lartë. Prokuroria për Krimet e Rënda ka ndjekur penalisht 4 gjyqtarë, përfshirë një gjyqtar të Gjykatës së Lartë, ndërsa 4 gjyqtarë të tjerë presin gjykimin. Në çështjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në 2017, prokurorët sekuestruan rreth \$57,000 (€50,000) nga një llogari bankare, duke përdorur për herë të parë parashikimin ligjor që lejon konfiskimin e vlerës së baraslershme me të ardhurat kriminale. Në raste të tjera, janë dënuar për korrupsion, një prokuror, një zyrtar i burgjeve dhe një kryetar bashkie janë dënuar për vepra penale të korrupsionit. Më 2018-n, prokurorët sekuestruan truall në pronësi të ish Prokurorit të Përgjithshëm, në kuadër të hetimit të tij për vepra penale. Në kontekstin e aksesimit në BE, vullneti politik për hetimin e zyrtarëve të lartë pritet të forcohet.*

Në Raportin e Raundit V të vlerësimit¹⁷ për masat kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit (AML/CFT) në Shqipëri, Komiteti i ekspertëve të MONEYVAL, konstaton se:...*Korrupsioni përbën kërcënim madhor për pastrimin e parave në Shqipëri. Shpesh i lidhur me krimin e organizuar, korrupsioni gjeneron sasi të konsiderueshme produktesh të veprës penale dhe cenon funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë penale. ... reforma e rëndësishme në gjyqësor, e cila është duke u implementuar, do të adresojë më mirë riskun e korrupsion që prevalon në vend.”*

Përmirësimi i efektivitetit të hetimeve penale në drejtim të zbatimit efektiv të ligjit, rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë, rritjes së personave të dënuar me vendim të formës së prerë veçanërisht zyrtarë të niveleve të larta, hetime më të mira financiare dhe procedura të gjetjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve dhe pasurive që burojnë nga krimi dhe praktikat korruptive; shtimit të

¹⁴ Miratuar me VKM nr. 241 datë 20.4.2018

¹⁵ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “Country Reports on Human Rights Practices for 2018”, publikuar në faqen zyrtare: <http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm?year=2018&dclid=289097>

¹⁶ Publikuar në faqen zyrtare:

<https://www.state.gov/documents/organization/290501.pdf> dhe

<https://www.state.gov/documents/organization/290502.pdf>

¹⁷ Publikuar në Korrik 2018 faqen e Këshillit të Evropës: <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/1680931f70>



përdorimit të teknikave speciale të hetimit, rritjes së aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, forcimi dhe rritja e kapaciteteve sasiore dhe cilësore të strukturave ligjzbatuese dhe hetimore, bashkëpunimi dhe skuadrat e përbashkëta hetimore janë drejtimit kryesore ku duhet të fokusohet lufta kundër korrupsionit nga organet ligjzbatuese.

Ngritja e Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Gjykatave Speciale kompetencë lëndore e të cilave është çdo akuzë penale kundër të gjithë zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të lartë shtetëror, si dhe të gjitha veprat penale të korrupsionit të konsumuara nga çdo shtetas, do të jetë një hap shumë i rëndësishëm që do të ndihmojë në rifitim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë dhe do të shënojë një gur themeli në luftën kundër korrupsionit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 në drejtim të luftës kundër korrupsionit nga organi i prokurorisë rezulton:

i) për veprat penale kundër korrupsionit janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të mjeteve/teknikave të posaçme/special të hetimit në kuadrin e 93 procedimeve penale, prej të cilëve 30 procedime i përkasin prokurorisë për krime të rënda dhe 63 procedime i përkasin prokurorisë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore ose krahasuar me vitin 2017 me shifra në rritje 14.4 për qind të procedimeve; **ii)** Në vitin 2018, në një rast, është vendosur sekuestrimi sipas ligjit antimafia mbi pasuritë e një subjekti të dënuar në shkallë të parë për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë; **iii)** Peshën më të lartë të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, konkretisht 43% të tyre e zë neni 259 i K. Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, për të cilën rezultoi të jenë regjistruar 74 procedime penale duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2017 ku kanë qenë 61 procedime të regjistruara. Për nenin 319 i K. Penal “Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” ka 2 procedime penale të regjistruara për 2018 nga 1 që ka qenë regjistruar për 2017. Për nenin 319/ç të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka

regjistruar 14 procedime penale nga të cilat 1 është dërguar në gjykatë; **iv)** Sa i përket ashpërsimit të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit, për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e vepra penale korruptive, 80% e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal janë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. 49% e kërkesave të prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, janë për caktimin e dënimit me burgim dhe 50% e tyre për caktimin e dënimit alternativ me burgim; **v)** Gjatë vitit 2018, bazuar në kallëzimet e paraqitura nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit janë regjistruar 24 procedime penale për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal. Nga këto 14 procedime/pandehur janë dërguar në gjykatë dhe për 11 të pandehur ka përfunduar gjykimi. Të dhënat krahasimore në dy vite, tregojnë tendencën në rritje të numrit të procedimeve për këtë veprë, e konkretisht nga 20 procedime të regjistruara në vitin 2017, në 24 procedime të regjistruara në vitin 2018 ose e shprehur në përqindje, me rritje 20% të procedimeve të regjistruara; **vi)** lidhur me forcimin e kapaciteteve profesionale ndërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, rezultoi se janë zhvilluar 6 aktivitete nga Shkolla e Magjistraturës me fokus luftën kundër korrupsionit, hetimin financiar, zbatimin e ligjit antimafia dhe parandalimin e pastrimit të parave, në të cilat kanë marrë pjesë 120 prokurorë. Tri prej këtyre trajnimeve janë zhvilluar në bashkëpunim me Euralius. Ndërkohë Pameca V, ka dhënë kontribut në forcimin e kapaciteteve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Ndër aktivitetet e organizuara nga ky projekt përmendim, zhvillimin në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, të tria sesioneve trajnuese lidhur me seancën paraprake ligjin antimafia; **vii)** Sa i përket rritjes së aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, prokuroria ka



nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme “Për dhënien e të drejtës të aksesit në prokurori të regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme”, me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit ka realizuar lidhjen për akses në disa module të portalit e-Albania dhe printimin e 5 dokumenteve; është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit midis Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Prokurorisë së Përgjithshme, “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në sistemin elektronik të prokurimeve”, për të cilin po vijon ende puna; është testuar me sukses lidhja midis dy sistemeve Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë dhe së shpejti kjo ndërlidhje do të pilotohet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan; **viii**) jepen të dhëna për 21 vepra penale të korrupsionit¹⁸ sipas të cilave rezulton se janë regjistruar 172 procedime penale, me 176 të pandehur dhe janë dërguar për gjykim 231 procedime me 203 të pandehur, nga të cilat janë dënuar 156 të pandehur. Krahasuar me 2017¹⁹ rezultojnë 101 procedime më pak të regjistruara me 21 të pandehur më pak, por ka një rritje prej 90 procedime më tepër të dërguara për gjykim, me 35 të pandehur me tepër; ndërsa ka një rënie të lehtë prej 2 të pandehurish më pak të dënuar.

ix) lidhur me çështjet e filluara/regjistruara kryesisht nga prokuroria për veprat penale të korrupsionit²⁰, numri total është 13 procedime dhe peshën kryesore e përbëjnë procedimet që lidhen me korrupsionin pasiv të funksionarëve të sistemit të drejtësisë dhe personave me funksione publike²¹.

Nga analiza e të dhënave statistikore, dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë nga organi i prokurorisë për vitin 2018 rezulton:

Janë hetuar 1721 procedime penale për veprat penale në fushën e korrupsionit²², me një numër total prej 372 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 300 persona. Rezulton se ka një rritje të numrit të çështjeve me 143 çështje më tepër, por rezulton ulje e numrit të personave nën hetim krahasuar me vitin e kaluar, 26 persona më pak. Gjithashtu ka një ulje prej 32 personash të marrë si të pandehur gjatë hetimit, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar²³. Rezulton se për vitin 2018 janë dërguar për gjykim vetëm 148 procedime penale ose rreth 8,6% të rasteve, me 285 të pandehur, krahasuar me vitin 2017²⁴, konstatohet rënie e numrit të çështjeve me 112 çështje më pak dhe 30 të pandehur më pak. Për vitin 2018 ka përfunduar gjykimi për 112 çështje penale (për veprat penale kundër korrupsionit) me një numër prej 207 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 165 persona, krahasuar me vitin 2017²⁵ ka një ulje prej 146 çështjesh dhe 75 të dënuar më pak.

Në vitin 2018, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 46892, nga të cilat vetëm 109 janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori, ose rreth 0,23% e numrit të përgjithshëm. Nga 109 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 22 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit, ose rreth 20% e numrit të çështjeve kryesisht, ku vendin kryesor e zë vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, me 8 çështje, ose 26 çështje më pak se në vitin 2017. Pra, konstatohet një ulje prej 24 çështjesh krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara kryesisht në 2017, ku kanë qenë regjistruar 46 çështje për vepra penale në fushën e korrupsionit.

Ndërsa, nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë rezulton se nga totali i çështjeve të filluara kryesisht, për veprën penale

¹⁸ Ku përfshihen nenet

124/a;164/a;164/b;244;245;245/1;259;259/a;260;312;319;319/a, 319/b;319/c;319/ç;319/d;319/dh;319/e;328;328/b por jo nenet 248,256, 257, 257/a të K.Penal.

¹⁹ Në vitin 2017 ishin 273 procedime penale të regjistruara me 196 të pandehur, janë dërguar për gjykim 141 procedime penale me 168 të pandehur dhe janë dënuar 158 të pandehur.

²⁰ Në material janë paraqitur për 6 vepra penale të korrupsionit, parashikuar nga nenet 244; 245/1; 259;259/a;260 dhe 319/cc të K.Penal.

²¹ Konkretisht neni 259 ka 4 çështje kryesisht dhe neni 319/ç ka 5 çështje kryesisht.

²² Bazuar në 22 veprat penale të analizuar edhe në dy vitet paraardhëse 2016, 2017, ku përfshihen këto nene 164/a; 164/b; 244; 244/a; 245; 245/1; 248; 256; 257; 257/a; 259; 259/a ;260; 312;319;319/a’319/b;319/c; 319/ç; 319/d; 319/dh; 319/e të K.Penal.

²³ Në 2017 ishin 1578 çështje në hetim me 398 persona nën hetim dhe 332 të pandehur.

²⁴ Në vitin 2017 numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto vepra ka qenë 260 (16,5% e rasteve) me 315 të pandehur.

²⁵ Në vitin 2017 kishin përfunduar gjykimin 258 çështje penale me 337 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 240 persona.



të pastrimit të parave rezultojnë 5 çështje²⁶ nga të cilat 4 çështje për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287/1 i K.Penal dhe 1 çështje për veprën penale “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, neni 287/b i K.Penal.

Në total numri i çështjeve të regjistruara për veprat penale të pastrimit të parave²⁷ është 269 çështje, me një numër total prej 35 personash nën hetim nga të cilët vetëm 15 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2017²⁸, rezulton se ka një rënie prej 51 çështjesh më pak të regjistruara me 13 persona nën hetim më pak dhe shtim të numrit të të pandehurve me 1 të pandehur më tepër.

Pra, vijon të mbetet një numër i vogël hetimesh pasurore të kryera nga organi i prokurorisë që lidhen me veprën penale të korrupsionit, ndërkohë që për vitin 2018 është rekomanduar rritje e numrit të hetimeve proaktive, shtimi i hetimeve sistematike pasurore dhe rritje e numrit dhe të cilësisë së hetimeve sidomos të rasteve të zyrtarëve të lartë publikë.

I njëjti konstatim vjen edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave²⁹ e cila thekson se, pavarësisht trajtimit me prioritetet të rasteve dhe rritjes së numrit të çështjeve krahasuar me vitet paraardhëse, mbetet i ulët numri i rasteve të dërguara për gjykim për veprën penale të parashikuar 287 KP, krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara për këtë vepër.

Sa më sipër me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Krijimin e një historiku solid me ndjekje penale dhe dënime për korrupsion, sidomos në nivele të larta nëpërmjet rritjes së numrit të personave të dënuar me vendim të formës së prerë;

ii) Zbatimin efektiv të ligjit nëpërmjet rritjes së numrit të hetimeve proaktive (çështje të filluara kryesisht dhe shtim të numrit të rasteve të

përdorimit të metodave speciale të hetimit), përmirësimin të cilësisë së hetimeve me qëllim suksesin e kërkesave të prokurorit në gjykatë;

iii) Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit, veçanërisht në rastet e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë;

iv) Shtim të numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe veçanërisht rritje e numrit të aseteve të sekuestruara dhe atyre të konfiskuara;

v) Rritje e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore;

vi) Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese vendase dhe ndërkombëtare sidomos për kryerjen e hetimeve pasurore financiare që lidhen me veprat penale të korrupsionit;

vii) Forcim të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, përfshirë edhe oficerët e policisë gjyqësore;

Lufta kundër krimit të organizuar

Forcimi i bashkëpunimit me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe terrorizmit, është një tjetër drejtim në të cilin është fokusuar Qeveria Shqiptare. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Eurojust-in³⁰, krijon mundësinë e një shkëmbimi të sigurt dhe eficient të informacionit gjyqësor dhe shkëmbimit të provave me organet dhe agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare në funksion të rritjes së efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Kjo marrëveshje ka për objekt zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke lehtësuar dhe bashkërendimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale që mbulojnë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian nëpërmjet krijimit dhe financimit të ekipeve të përbashkëta hetimore.

Në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me iniciativë të Ministrisë së Drejtësisë

²⁶ ka një rritje prej 2 çështjesh krahasuar me vitin 2017.

²⁷ nenet 287, 287/a dhe 287/b të Kodit Penal.

²⁸ Në vitin 2017 për këto tri vepra penale janë regjistruar 320 çështje me 48 persona nën hetim dhe 14 të pandehur.

²⁹ Me shkresën e saj nr. 243/1 prot., datë 21.2.2018, regjistruar me tonën nr. 1466/1 prot., datë 22.2.2019.

³⁰ Marrëveshja është ratifikuar me ligjin nr. 113/2018, botuar në fletoren zyrtare nr. 197 të vitit 2018, publikuar në faqen zyrtare: <https://qbz.gov.al/cli/fz/2018/197/c296680f-0015-4e9c-8bcf-76fb6f7bb626>



Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datën 25.2.2019³¹ kanë nënshkruar Planin e Veprimit në kuadër të nënshkrimit dhe zbatimit të marrëveshjes së mësipërme. Ky plan veprimi përmban detyrimin e Prokurorisë së Përgjithshme si autoritet zbatues të kësaj marrëveshjeje për ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar përpunimin e të dhënave personale në veprimtarinë e prokurorisë në nivel qendror dhe vendor, si dhe për të adresuar të gjitha problematikat që do të konstatohen në këtë proces. Zyra e Komisionerit do të asistojë organin e akuzës në zbatimin e standardeve më të larta për masat tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave. Po ashtu, do të bashkëpunohet për të përshtatur Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Prokurorisë së Përgjithshme me detyrimet specifike të Marrëveshjes me EUROJUST.

Në tjetër pikë me rëndësi e planit të veprimit edhe krijimi i “Regjistrimit për komunikimet mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe EUROJUST”. Ky dokument është një mekanizëm për garantimin, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të fushës, të të drejtave të qytetarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organit të akuzës. Njëkohësisht, “Planveprimi” ka përcaktuar dhe afate konkrete në realizimin e gjitha këtyre masave.

Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, trafikut të drogave është një nga drejtimet ku është fokusuar lufta kundër krimit të organizuar. Aktualisht Shqipëria ka një kuadër të gjerë dhe të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e lëndëve narkotikëve si Plani Kombëtar kundër Kanabisit³². PPKK-ja mban në konsideratë faktorët bazë që nxisin kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike në vend, ndër të cilët mund të përmendim: kushtet ende të vështira social-ekonomike, kërkesën ndërkombëtare përherë në rritje, zbatimin e

standardeve të ndryshme ligjore në vendet e destinacionit për konsumin e drogës, bashkëpunimin e ngushtë të rrjeteve kriminale në vend me rrjetet kriminale të Bashkimit Evropian, si dhe fuqinë financiare dhe fleksibilitetin për t’iu adaptuar këtyre grupeve. Theksi kryesor i PPKK-së është përpjekja e përbashkët ndërinstitucionale për goditjen e gjithanshme dhe frontale me qëllim identifikimin, zbulimin dhe shkatërrimin e grupeve dhe rrjeteve kriminale që janë aktive në fushën e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe jo vetëm.

Suksesi i institucioneve dhe strukturave të ngarkuara me parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe përdorimit të kanabisit në vend matet me identifikimin, zbulimin, ndalimin dhe vënien përpara drejtësisë të financuesve dhe drejtuesve të grupeve dhe rrjeteve kriminale.

Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal është po ashtu një tjetër drejtim kryesor ku duhet të fokusohet lufta kundër krimit të organizuar.

Një hap i rëndësishëm në luftën që po organizon Shqipëria kundër krimit të organizuar dhe masave konkrete që po ndërmerren në kuadër të kësaj lufte shënon dhe hyrja në fuqi e ndryshimeve të ligjit, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”³³, ose të regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë, i ashtuquajtur nga të gjithë “neni 41 bis”³⁴. Ligji parashikon regjim të posaçëm për të dënuarit/ paraburgosurit në burgun e sigurisë së lartë, për një kategori të caktuar veprash penale³⁵ me qëllim ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me

³³ Ligji nr. 108/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197 të vitit 2018, publikuar në faqen zyrtare: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/197/c296680f-0015-4c9c-8bcf-76fb6f7bb626>

³⁴ referuar modelit italian

³⁵ neni 1 i ligjit parashikon veprat penale sipas neneve 79, shkronja "ç", 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste

³¹ Nr. 334 prot të KDIMDP dhe nr. 623 prot. të PP-së, publikuar në faqen zyrtare: http://www.idp.al/ep-content/uploads/2019/03/Planveprimi_PP_KDIMDP.pdf

³² Plani Kombëtar kundër Kanabisit miratuar me VKM nr. 248, datë 29.3.2017 “Për miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017–2020”, ndryshuar me VKM nr. 313, datë 31.5.2018.



organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera; si dhe nevojën për të parandaluar kontaktet/ konfliktet e mundshme, ndërveprimin me të burgosur të tjerë dhe shkëmbimin e sendeve me ta.

Komiteti i ekspertëve të MONEYVAL të Këshillit të Evropës në raportin e Raundit V vlerësues³⁶ për masat kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit (AML/CFT) në Shqipëri konstaton se: *“Hetimet për pastrimin e parave rrallë përfundojnë me dënimin e autorëve dhe numri i këtyre çështjeve është në rënie. Procedimet për pastrimin e parave të lidhura me vepra të rënda shpesh pezullohen ose pushohen nga prokuroria. Numri i veprave penale kryesore që parashikohen nga legjislacionit është në përputhje me kërënimet që paraqet situata në vend, por numri dhe lloji i çështjeve të pastrimit të parave nuk është konsistent me përmasat dhe rrezikshmërinë e kriminalitetit që gjeneron këto të ardhura. niveli i provave që nevojitet për lidhjen midis veprës kryesore dhe pastrimit të parave nuk është gjithmonë e qartë për praktikuesit e ligjit. Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë në lidhje me konfiskimin e asetëve kriminale, por statistikisht tregojnë se numri dhe vlera e sendeve të sekuestruara nuk përputhet me nivelin e kriminalitetit në vend. në praktikë regjimi i konfiskimit bazuar në ligjin antimafia përdoret më tepër se regjimi i konfiskimit penal, i cili është i detyrueshëm dhe zbatohet për të gjitha kategoritë e veprave penale. autoritetet kanë treguar se sistematikisht aplikohet hetimet paralele financiare, por performanca ka qenë e mangët.”*

Problematika për numrin e ulët të regjistrimit apo dërgimit në gjyq të procedimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale është evidentuar edhe nga vetë organi i prokurorisë.³⁷

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike”³⁸

³⁶ Publikuar në Korrik 2018 faqen e Këshillit të Evropës:

<https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/1680931f70>

³⁷ Në analizën e prokurorisë së juridiksionit të apelit Tiranë datë 27 Mars 2019 Prokuroria e Përgjithshme e Përkohshme ka evidentuar se: për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ka shumë pak çështje që janë regjistruar dhe aq më pak që të jenë dërguar për gjykim. Kjo situatë nuk i përgjigjet aspak realitet dhe është një nga pikat e dobëta për të cilat Shqipëria ka marrë kritika të shumta nga komiteti Moneyval (institutoni i monitorimit të pastrimit të parave) dhe mund të penalizohet. Pra, hetimet janë të pakta dhe jo të suksesshme për këtë vepër penale.

³⁸ Publikuar në faqen zyrtare:

<https://www.state.gov/documents/organization/290501.pdf>

për vitin 2018, në volumnin e parë, midis të tjerave ka përmendur se: *“... Sasia e lëndës së sekuestruar dhe arrestet për lëndë narkotike janë rritur ndjeshëm në 2018, për shkak edhe të rritjes së bashkëpunimit të organeve ligjzbatuese me partnerët ndërkombëtarë, presionit ndërkombëtar dhe përpjekjeve të Shqipërisë drejt integritetit në BE... Përpjekjet për zhdukjen dhe ndjekjen penale të kultivuesve të kanabisit kanë qënë të gjera, por jo uniforme, ndërsa ndërprerja e infrastrukturës së trafikut të narkotikëve të krijuar prej dy dekadash mbetet një sfidë. ...Gjendja e status quo, që rrallë përfundon me dënimin, nuk përbën faktor frenues për kriminelët. Shqipëria, megjithatë është duke ecur drejt reformës në drejtësi për të ndjekur penalisht dhe dënuar trafikantët e drogës dhe lidhjet me krimin e organizuar. Prokurorët aktualisht hetojnë paralelisht akuzat për krim të organizuar me akuzat për narkotikët... Është jetësore vijimi i implementimit të reformës në drejtësi dhe puna për shfarosjen e influencës së krimit të organizuar.*

Ndërsa në volumnin e dytë³⁹ midis të tjerave përmendet se: *“Veprat penale që gjenerojnë më tepër të ardhura në Shqipëri janë trafikimi i narkotikëve, evazioni fiskal dhe kontrabanda. Vepra të tjera penale janë falsifikimet, trafikimi i personave dhe i armëve. ...Projektet e zhvillimit të territorit, ndërtimi dhe lojërat e fatit janë metodat më prevalente për fshehjen e të ardhurave. Në 2018 Shqipëria miratoi një ligj për ndalimin e basteve sportive, kazinove online dhe kufizimin e kazinove reale. Ky ndryshim pritet të kufizojë mundësitë e trafikantëve për pastrimin e fondeve të paligjshme... Shqipëria duhet të zbatojë efektivisht ligjet dhe të forcojë kapacitetin e policisë dhe prokurorisë, duke u fokusuar në korrupsionin, pastrimi i parave dhe krimi ekonomik. Pavarësisht një numri të lartë hetimesh për pastrim parash vitet e fundit, numri i procedimeve mbetet i ulët...”*

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar nga organi i prokurorisë rezultojnë:

i) Në strategjinë e saj afatmesme 2018–2020, Prokuroria ka përcaktuar si objektiv forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me autoritetet vendase dhe të huaja, si në nivel operacional, ashtu dhe nëpërmjet përgjigjes në kohë e me eficiencë lidhur me trajtimin e letërkërkesave të

³⁹ Publikuar në faqen zyrtare:

<https://www.state.gov/documents/organization/290502.pdf>

⁴⁰ Me shkresën nr. 1266/22 prot., datë 28.3.2019, regjistruar me tonën me nr. 1465/1 prot., datë 29.3.2019.



autoriteteve të huaja. Në këtë kuadër, në muajin shkurt 2018 është nënshkruar një marrëveshje mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, anëtarëve të grupeve të strukturuar kriminale, aseteve dhe të ardhurave të tyre të paligjshme, si dhe rritjen e efektivitetit në hetimet penale dhe vënien para përgjegjësive së autorëve. Në zbatim të kësaj marrëveshje, Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr. 1, datë 20.2.2018, “Për krijimin e seksioneve të posaçme” në 10 prokurorinë për krime të rënda dhe në 9 (nëntë) prokurori të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm; **ii)** Mbështetur në rekomandimet e Progres Raportit dhe në zbatim të rekomandimeve të KM-së për kryerjen e hetimeve pasurore sistematike dhe rritjen e numrit të pasurive të sekuestruara që nga faza fillestare e hetimit, në datë 20.11.2018, Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr. 6/2018, “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, me synim unifikimin e zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” ndaj personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin, korrupsionin, pastrimin e produkteve të veprës penale etj., si dhe për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale; **iii)** Në zbatim të ligjit nr. 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për vitin 2018, prokurorët kanë paraqitur në gjykatë 7 kërkesa për sekuestrim dhe 4 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara. Pasuritë objekt i këtyre vendimeve janë apartamente, troje, automjete me vlera të konsiderueshme, ndërsa veprat penale që ka shërbyer si indicie për hetimin pasuror kanë qenë ato të pastrimit të parave dhe trafikimit të narkotikëve. Në një rast prokuroria ka kërkuar në gjykatë dhe është pranuar kërkesa për sekuestrimin e pasurisë së një subjekti të dënuar në shkallë të parë për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe

funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 6/2018 seksionet e ngritura për hetimin e krimit ekonomik, financiar e kibernetik dhe seksionet e posaçëm në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale kanë kërkuar dhe nga gjykatat është vendosur sekuestro proventive të sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale, duke përmendur raste sekuestrimi llogarish bankare, pasurive të paluajtshme, shoqëri tregtare dhe kuota në shoqëri tregtare; **iv)** Sa i përket rritjes së numrit dhe cilësisë së hetimeve, duke përdorur teknikat speciale të hetimit, gjatë vitit 2018 janë kryer hetime me përdorim të mjeteve/teknikave të posaçme/special të hetimit, si në kuadrin e 250 procedimeve penale për veprën penale në fushën e narkotikëve, prej të cilëve 104 procedime i përkasin prokurorisë për krime të rënda dhe 146 procedime i përkasin prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, ashtu dhe në kuadrin e 37 procedimeve për veprat penale në fushën e trafikëve të paligjshme që i përkasin prokurorisë për krime të rënda; **v)** Sa i përket rekomandimit për ashpërsimin e politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit, prokuroria gjatë vitit 2018 ka ndjekur një politikë të ashpër penale për të pandehurit që kanë kryer këto grup-vepra penale dhe kjo pasqyrohet në të dhënat konkrete lidhur me kërkesat për masat e sigurimit persona, ku 99,5% janë kërkesa për caktimin e masës të sigurimit “arrest në burg” dhe në kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, ku të gjitha janë për caktimin e dënimit me burg, prej të cilave: -92% në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 3% në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 5% e kërkesave për caktimin e dënimit me burgim të përjetshëm; **vi)** Jepen të dhëna për veprën penale që parashikohet nga neni 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”, për të cilën rezultoi se janë regjistruar 41 procedime, prej të cilëve 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me rritje rreth 2,5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale.. Krahasuar me vitin 2017 për këtë



kategori veprash penale⁴¹ rezulton një rritje prej 24 procedimesh të regjistruara me 36 të pandehur më tepër, por një rënie me 2 procedime më pak dërguar për gjykim me 16 të pandehur më pak për gjykim, ndërsa është rritur numri i të pandehurve të dënuar dyfish ose 30 të dënuar më tepër. Për vitin 2018 nuk rezultojnë procedime penale të regjistruara dhe as dërguara për gjykim për veprat penale ta parashikuara nga nenet 333 dhe 334 të K.Penal; **vii)** Jepen të dhëna për veprën “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal ku janë regjistruar 1127 procedime, prej të cilëve 447 procedime janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 5,5% të numrit të procedimeve të regjistruara; për veprën “Kultivimi i bimëve narkotikëve” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, ku janë regjistruar 292 procedime penale, prej të cilëve 46 procedime janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 22% të numrit të procedimeve të regjistruara; **viii)** Lidhur me veprat penale kundër trafikeve jepen këto të dhëna: Për vitin 2018 janë regjistruar 284 procedime penale për 7 vepra penale⁴², me 150 të pandehur, nga të cilat janë dërguar për gjykim 47 procedime me 105 të pandehur dhe janë dënuar 90 të pandehur; **ix)** Jepen të dhëna për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe pastrimit të parave të parashikuara nga nenet 287, 287/a e 287/b të Kodit Penal, ku rezulton se për vitin 2018 për këto tri vepra janë regjistruar gjithsej 269 procedime penale, prej të cilëve janë dërguar për gjykim 23 procedime penale. Ndërsa për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, që zë peshën kryesore në këtë grup veprash rezulton se janë regjistruar 257 procedime, prej të cilëve 17 procedime janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2017 me ulje prej 16% të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër; **x)** Të dhënat

statistikore të vitit 2018, për veprat penale kundër terrorizmit, janë fokusuar në veprën penale “Financimi i terrorizmit” të parashikuar nga neni 230/a i Kodit Penal ku rezulton se janë regjistruar 4 procedime penale ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 33% të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër; **xi)** Në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për grupet e strukturuar kriminale, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin nr. 2, datë 18.6.2018 për të përmirësuar koordinimin e informacionit dhe ndjekjen e tij në çështjet e ekstradimit për jashtë. Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me agjencitë e huaja ligjzbatuese janë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetit Suedez të Prokurorisë; Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Republikës së Bullgarisë dhe Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë; është miratuar në parim marrëveshjen e bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it; si dhe janë nënshkruar 3 marrëveshje për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, në kuadër të çështjeve penale të regjistruara për veprën penale të “Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike”. Gjithashtu jepen të dhëna lidhur me kërkesat në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë.

Nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë për vitin 2018 lidhur me veprat penale të krimit të organizuar rezulton :

Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike⁴³, janë hetuar 2459 çështje penale ose 608 çështje penale më pak se viti 2017. Janë dërguar për gjykim 533 çështje ose 21,7% e çështjeve me 772 të pandehur⁴⁴. Janë hetuar 1114 persona dhe janë marrë të pandehur 915 persona. Krahasuar me vitin 2017 rezultojnë 238 persona më pak të hetuar dhe 380 më pak të pandehur.

Numrin më të lartë të çështjeve në hetim

⁴¹ Për vitin 2017 për veprat penale të krimit të organizuar të parashikuar nga nenet 333, 333/a dhe 334 të K.Penal janë regjistruar 17 procedime penale, me 34 të pandehur, janë dërguar për gjykim 8 procedime penale me 46 të pandehur dhe janë dënuar 30 të pandehur.

⁴² Veprat penale të paraqitura në tabelë janë 7 veprat e parashikuara nga nenet 110/a; 128/b; 138/a; 141/a; 278/a; 282/a dhe 283/a të K.Penal.

⁴³ Ku janë përfshirë 283/a; 283/b; 284/cc; 285/a; 285/b; 286 dhe 286/a të K.Penal.

⁴⁴ Krahasuar me të dhënat e vitit 2017, rezulton ulje prej 256 çështje më pak për gjykim dhe 354 të pandehur më pak.



vijojnë ta zënë veprat penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” neni 283 K. Penal me 1624 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 447 çështje; “Kultivimi i bimëve narkotike”, neni 284 K. Penal me 500 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 46 çështje.

Nga këto të dhëna konstatohet qartë se ka rënie të numrit të çështjeve të hetuara dhe gjykuara për këto vepra penale⁴⁵ dhe ajo çfarë është më e dukshme është ulja e numrit të procedimeve dhe i të pandehurve që janë dërguar për gjykim nga organi i prokurorisë, veçanërisht është ulur edhe numri i pandehurve të dënuar.

Lidhur me veprat penale të trafikimit⁴⁶, për vitin 2018 rezulton se janë regjistruar 215 çështje penale me 36 persona në hetim, nga të cilët vetëm 8 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 23 çështje me 35 të pandehur, ose rreth 10,7% e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të hetuara e zë vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” me 139 çështje të regjistruara.

Nga analiza e të dhëna statistikore për veprat penale të trafikimit rezulton një rënie e numrit⁴⁷ të çështjeve të regjistruara, personave nën hetim dhe të marrë si të pandehur. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2018, numri i tyre është rritur me 1 çështje më tepër dhe numri i pandehurve është rritur me 7 krahasuar me vitin 2017⁴⁸.

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 41 çështje me 43 persona nën hetim për veprat penale të krimit të organizuar, ku të gjitha çështjet janë regjistruar për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” neni 333/a i K. Penal. Për këto vepra penale, gjatë vitit 2018 janë dërguar për gjykim 6 çështje me 30 të pandehur për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” neni 333/a.

Për këtë kategori veprash penale, konstatohet

⁴⁵ Vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, neni 283 KP ka një rënie prej 56 çështje më pak në hetim dhe 149 çështje më pak në gjykim. Vepra penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, neni 284 KP, ka pësuar pothuajse një përgjysmim të çështjeve, me 523 çështje më pak në hetim dhe 88 çështje më pak të dërguara për gjykim.

⁴⁶ Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të K. Penal.

⁴⁷ Në vitin 2017 ishin regjistruar 21 çështje penale me 42 persona në hetim, nga të cilët 12 janë marrë si të pandehur.

⁴⁸ Në vitin 2017 ishin dërguar për gjykim 22 çështje me 28 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

një rritje e ndjeshme e numrit të çështjeve të regjistruara prej rreth 2,5 herë më tepër krahasuar me vitin 2017⁴⁹ dhe rritje e numrit të personave nën hetim me rreth 2 herë më tepër⁵⁰, por ka një rënie të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim dhe numrit të personave të marrë si të pandehur⁵¹.

Lidhur me veprat penale me natyrë terroriste⁵², rezulton se janë regjistruar në total 4 çështje për vitin 2018 të cilat janë regjistruar për veprën “Financimi i terrorizmit” parashikuar nga neni 230/a i K. Penal. Për këto çështje të regjistruara nuk ka persona në hetim dhe as persona të marrë në cilësinë e të pandehurit. Nuk rezulton asnjë çështje e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2018, megjithatë krahasuar me vitin 2017, vihet re një ulje e numrit të çështjeve të regjistruara me 2 çështje më pak⁵³.

Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura⁵⁴ për vitin 2018 janë regjistruar 5 çështje penale për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” parashikuar nga neni 265 i K. Penal me 2 persona të marrë si të pandehur. rezulton një rënie e numrit të çështjeve me 4 çështje më pak krahasuar me vitin 2017, por nuk rezulton asnjë çështje e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash.

Sa më sipër, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Përmirësim i cilësisë së hetimeve nëpërmjet rritjes të numrit të procedimeve penale/të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe numrit të pandehurve të dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për veprat penale të *Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale* parashikuar nga

⁴⁹ Në vitin 2017, numri i çështjeve të regjistruara ishte 17 çështje.

⁵⁰ Në vitin 2017 numri i personave nën hetim ishte 20 ose 21 persona më pak se 2018.

⁵¹ krahasuar me 2017, ka 2 çështje më pak për gjykim dhe 15 të pandehur më pak.

⁵² Nenet 230-232/b të Kodit Penal.

⁵³ Në vitin 2017 ishin 67 çështje të regjistruara por nuk kishte persona nën hetim dhe as të pandehur. gjithashtu as për vitin 2017 nuk ka pasur çështje të dërguara për gjykim për këtë kategori veprash penale.

⁵⁴ Nenet 265-265/c të K. Penal.



neni 287, 283,284/a të Kodit Penal.

ii) Hetime financiare cilësore lidhur me rastet e organizatave apo grupeve të strukturuar kriminale me fokus rritjen e numrit të aseteve të sekuestruara, që në fazën fillestare të hetimit dhe rritje të numrit të aseteve të konfiskuara;

iii) Rritje të numrit të hetimeve proaktive me qëllim identifikimin, dërgimin në gjykatë dhe dënimin e drejtuesve të organizatave kriminale që lidhen me veprat penale të krimit të organizuar;

iv) Forcimin e bashkëpunimit me organet dhe agjencitë ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare në rastet e krimit të organizuar që lidhet me financimin e terrorizmit, organizimin dhe drejtimin e organizatave kriminale, trafikimin e narkotikëve, trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimit të produkteve që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale;

v) Në zbatim të planit të veprimit të marrëveshjes me EUROJUST, është e nevojshme marrja e masave për plotësimin dhe sigurimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale, krijimi i regjistrit për komunikimet me Eurojust;

vi) Mbajtjen në konsideratë të nevojës për zbatimin e ligjit nr. 108/2018 për vendosjen në regjimin e posaçëm të të dënuarve/parburgosurve për veprat penale të parashikuara nga ky ligj;

vii) Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, në funksion të shpejtësisë dhe efektivitetit të së hetimeve;

viii) Forcimi të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të agjencive të zbatimit të ligjit me qëllim kuptimin dhe zbatimin e njëjtë të ligjit dhe evidentimin e praktikave të mira.

Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut

Respektimi i të drejtave të njeriut është padyshim një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare me fokus të veçantë të grupet vulnerabël të shoqërisë.

Miratimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit⁵⁵ shoqëruar me Planin e Veprimit 2018–2021 ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2018 dhe përbën dokumentin e parë të politikave të qeverisë shqiptare që përcakton shtyllat bazë të reformës së drejtësisë për të miturit.

Paketa ligjore, për të drejtat e të miturve, synon promovimin dhe mbrojtjen më efektive të të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve. Zbatimi efektiv i saj kërkon angazhimin institucional të organeve ligjzbatuese, bashkëpunimin midis aktorëve që veprojnë në fushën e drejtësisë penale dhe të drejtave të njeriut; forcimin e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve gjithëpërfshirëse sistematike, me qëllim garantimin e një procesi që mbron interesin më të lartë të të miturit.

Dhuna në familje është një nga drejtimet ku Qeveria ka fokusuar punën e saj nëpërmjet programeve, iniciativave dhe strategjive për adresimin më të mirë të rasteve të dhunës në familje. Ndryshimet⁵⁶ në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, garantojnë mbrojtjen me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe të çdo individi.

Në raportin e Komisioneres të Këshillit të Evropës Dunja Mijatović pas vizitës në Shqipëri në datat 21–25 maj 2018⁵⁷ përmendet se iu bëhet thirrje autoriteteve shqiptare të shtojnë veprimet për errënjosjen e dhunës ndaj fëmijëve, duke forcuar kapacitetet e shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe profesionistëve për identifikimin dhe përballjen me dhunën, si dhe duke synuar parandalimin. autoritetet inkurajohen të ndërmarrin fushatën për zero tolerancë ndaj dhunës... me shqetësim konstatohet impakti i dhunës në familje të fëmijët dhe disa problematika në lidhje me ndjekjen penale dhe gjykimin e këtyre veprave,... Komisioneri inkurajon autoritetet të vijojnë me përpjekjet për ofrimin e trajnimeve të përsëritshme dhe sistematike për profesionistët të cilët punojnë me të miturit dhe në

⁵⁶ Miratuar me ligjin nr. 47/2018.

⁵⁷ publikuar në faqen e KE-së: <https://rm.coe.int/report-on-the-visit-to-albania-from-21-to-25-may-2018-by-dunja-mijatovic/16808d2e22>

⁵⁵ Miratuar me VKM nr. 541, datë 19.9.2018.



zbatimin e parimit të interesit më të lartë të të miturit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, nga organi i prokurorisë rezulton:

i) Në kuadrin e projektit të Mbretërisë së Suedisë, përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, “Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligj-zbatuese shqiptare për përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit- një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë”, prokuroria ka marrë dhe po merr asistencë për rritjen e kapaciteteve, ashtu si dhe agjencitë e tjera shqiptare të zbatimit të ligjit dhe gjykatave, për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit; **ii)** Në janar 2018 në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur strukturë e posaçme për ndihmën ndaj subjekteve me status të posaçëm me përbërje prokurorë dhe ndihmës/psikologë. Fillimisht janë caktuar në funksionet koordinatorë/psikolog të viktimave vetëm në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Durrës, ndërsa pas miratimit të shtesës së numrit të punonjësve Prokurorisë së Përgjithshme me ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, në strukturën e vitit 2019 Prokurori i Përgjithshëm caktoi kordinatorë/psikologë të viktimave në gjithë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm; **iii)** Prokurori i Përgjithshëm në datë 26.10.2018, ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 5/2018 për garantimin e asistencës të miturve viktimat dhe dëshmitar të veprave penale i cili është hartuar me asistencën e OPDAT-it, është miratuar edhe një broshurë informative për viktimat e krimit, që është shpërndarë në prokuroritë e shkallës së parë dhe është publikuar edhe në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme; **iv)** sipas informacionit të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, prokurorët në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin dhe me viktimat apo dëshmitar të mitur kanë marrë masa për zbatimin e ligjit për sigurimin e pjesëmarrjen e psikologut gjatë hetimit; ruajtjen e sekretit të informacionit dhe ndalimit të publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore në ngarkim të pandehurve të mitur dhe për viktimat/dëshmitar të mitur; procedimin e sa më pak raste me

arrestime apo ndalime me subjekt procedural të mitur, duke i kryer hetimet ndaj tyre në gjendje të lirë dhe/ose me masa sigurimi të lehta si “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 të K.Pr.Penale, ndërsa masa e sigurimit “Arrest në burg” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale është caktuar vetëm në raste specifike dhe të rralla për të mitur që kanë kryer vepra penale të rënda, ose që kanë qenë recidivisht në kryerjen e veprave penale; shkurtimi i kohëzgjatjes së afatit të hetimeve në çështjet me të mitur dhe kryerja e veprimeve hetimore të kryhet në mënyrë të përsheptuar; vëmendje në caktimin e masës së dënimit, duke kërkuar kërkimin e dënimeve të lehta apo aplikimin e dënimeve alternative dhe aplikimin e shmangies së të miturve nga dënimi, duke pasur parasysh riedukimin dhe riintegrimin e tyre, si dhe parandalimin e kryerjes të veprave penale nga ta miturit. Në informacionin e përcjellë nuk përmenden statistika të këtyre rasteve; **v)** Sa i përket ndjekjes penale të veprave penale ndaj fëmijëve e familjes dhe për vepra kundër fëmijëve martesës e familjes, të parashikuara nga seksioni IX i Kodit Penal, në vitin 2018, jepen të dhëna se janë regjistruar 1349, prej të cilëve 1050 procedime penale janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 7,73% të procedimeve të regjistruara për këtë grup-veprash penale. Dhuna në familje zë peshën më të lartë të procedimeve në këtë grup-veprash, rreth 89,62%, e konkretisht 1209 procedime penale të regjistruara, prej të cilave 1007 procedime penale janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me ulje prej 7,71% të procedimeve të regjistruara për këtë vepër; **vi)** Sa i përket veprës penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, jepen të dhëna se në vitin 2018 janë regjistruar 14 procedime ose me ulje prej 44% të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2017. Sa u përket kërkesave për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për këtë vepër, nga prokurorët është kërkuar në 3 raste burgim i përjetshëm, në 3 raste burgim në maksimumin e marzheve me burgim të parashikuar nga ligji për këtë vepër, në 1 rast burgim në mesataren e marzheve. Ndërsa në rastet kur këto vepra penale kanë mbetur në fazën e tentativës, në 3 raste është kërkuar caktimi i dënimit me burgim në minimumin e



marzheve me burgim të parashikuar nga ligji për këtë vepër.

Nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë për vitin 2018 rezulton:

Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës⁵⁸ rezulton se për vitin 2018 janë regjistruar 1354 çështje penale me 395 persona nën hetim dhe janë marrë 869 të pandehur. Krahasuar me vitin 2017⁵⁹ rezultojnë 115 çështje më pak të regjistruara, por 17 persona më tepër nën hetim, ndërkohë që ka një rënie prej 124 të pandehurish. Në lidhje me këtë kategori veprash rezulton se për vitin 2018 janë dërguar për gjykim 1052 çështje me 118 të pandehur, me një rënie prej 53 çështjesh dhe 34 të pandehurish më pak krahasuar me 2017⁶⁰.

Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, për vitin 2018 janë regjistruar 1209 çështje penale ose rreth 2,8% e të gjitha çështjeve penale të regjistruara⁶¹, me 353 persona nën hetim. Për këto çështje janë marrë në cilësinë e të pandehurit 842 persona.

Rezulton se janë dërguar për gjykim 1007 çështje për këtë vepër penale me total prej 1069 të pandehurish, ose rreth 8,5% e të gjitha çështjeve të dërguara për gjykim⁶². Krahasuar me vitin 2017 konstatohet një rënie e numrit të çështjeve të regjistruara dhe personave të marrë si të pandehur, si dhe një rënie e numrit të numër më i ulët i çështjeve të dërguara për gjykim⁶³. Nga këto çështje për vitin 2018 janë gjykuar 777 çështje me 820 të pandehur, duke pësuar një rënie me 176 çështje më pak dhe 191 të pandehur më pak se në vitin 2017.

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjyqimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për dhunën në familje vetëm për 12 të pandehur është kërkuar dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës i dispozitës (krahasuar me 9 raste në vitin 2017), ndërsa: (i)

për 1 rast është kërkuar dënimi me gjobë; (ii) për 298 të pandehur është kërkuar dënim mesatar; (iii) për 229 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita⁶⁴; (iv) për 299 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit⁶⁵; dhe (v) për 10 të pandehur për paragrafin e katërt të dispozitës është kërkuar tërheqja e akteve. Ndërkohë që për vitin 2018 është rekomanduar ashpërsim i politikës së dënimit për rastet e dhunës në familje.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në çështjet penale të regjistruara gjatë vitit 2018, ka pasur 555 të pandehur të mitur të moshës 14-18 vjeç, nga të cilët 517 janë meshkuj dhe 38 femra, ndërsa kanë rezultuar 65 viktima të mitur nga të cilët 34 meshkuj dhe 31 femra.

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme⁶⁶ për të miturit për vitin 2018, në prokuroritë e rretheve gjyqësore janë regjistruar 423 procedime, me 481 persona në hetim. Për sa u përket masave të sigurimit personal, rezulton se në 25 raste është caktuar masa e sigurisë personale “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K. Pr.Penale, në 11 raste është caktuar masa e sigurisë “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, në 3 raste është caktuar masa e sigurisë “Vendosja në mbikëqyrje” nga neni 83 i K.D.P.M. dhe në 66 raste janë vendosur masa të tjera sigurimi. Në lidhje me masën e sigurimit persona “arresti në burg” konstatohet se ajo është caktuar në rreth 24% të rasteve.

Në lidhje me mënyrën e përfundimit të procedimeve penale, rezulton se në 98 raste ose 27%⁶⁷ të çështjeve të përfunduara me 115 të pandehur janë vendosur masat alternative të shmangies. Në 2 raste me 2 të pandehur është vendosur pushimi i çështjes me ndërmjetësim dhe në 235 raste me 295 të pandehur është kërkuar gjyqimi i çështjes.

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjyqimi i drejtpërdrejtë vijon të mbetet një nga llojet e gjyqimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë. Organi i prokurorisë për vitin 2018

⁵⁸ Seksioni IX „nenet 124- 130/a të Kodit Penal.

⁵⁹ Në vitin 2017 ishin regjistruar 1469 çështje me 378 persona nën hetim dhe 993 të pandehur.

⁶⁰ Në vitin 2017 ishin dërguar për gjykim 1105 çështje me 1152 të pandehur.

⁶¹ Për vitin 2018 janë regjistruar në total 43752 çështje.

⁶² Për vitin 2018 janë dërguar për gjykim 11790 çështje.

⁶³ Për vitin 2017 janë regjistruar 1310 çështje me 327 persona nën hetim dhe 952 persona në cilësinë e të pandehurit gjatë hetimeve, nga të cilat janë dërguar për gjykim 1057 çështje.

⁶⁴ Në vitin 2017, dënimi minimal është kërkuar për 166 të pandehur.

⁶⁵ Në vitin 2017, pezullimi i ekzekutimit është kërkuar për 343 të pandehur.

⁶⁶ Përcjellë në rrugë elektronike në datën 12.4.2019.

⁶⁷ Totali i çështjeve të përfunduara sipas statistikave rezulton 363 çështje.



ka dërguar për gjykim 11790 çështje (nuk përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por vetëm për 315 prej tyre prokuroria ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë ose me rreth 2,7%.%. Rezulton një rritje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2017⁶⁸ por një ulje e çështjeve për të cilat është kërkuar gjykim i drejtpërdrejtë. Ndërkohë që për vitin 2018 është rekomanduar rritje e rasteve të kërkuara nga organi i prokurorisë për gjykimin e drejtpërdrejtë.

Gjatë vitit 2018, janë paraqitur 591 kërkesa për miratim të urdhrin penal, me 619 të pandehur, nga të cilat janë miratuar 548 urdhra penale ose rreth 92% e kërkesave të paraqitura. Po gjatë këtij viti, janë paraqitur 570 kërkesa për miratim të marrëveshjes me 621 të pandehur prej të cilave janë miratuar 532 kërkesa nga gjykata ose rreth 93% e kërkesave të paraqitura. Krahasuar me numrin total të çështjeve të dërguara për gjykim për këtë vit⁶⁹, numri i çështjeve për të cilat është kërkuar miratimi i urdhrin penal dhe marrëveshjes është relativisht i ulët rreth 9,8%.

Me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Rritje të numrit të rasteve të zbatimit të urdhrin penal, marrëveshjes dhe gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim përmirësimin e efikasitetit të hetimit dhe uljes së normës së kohëzgjatjes mesatare të hetimit të çështjeve;

ii) Rritje të kërkesave për dhënien e dënimeve alternative për autorë dhe vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore;

iii) Rritje të numrit të masave alternative që synojnë shmangien e të miturit autor të veprës penale nga procedimi penal;

iv) Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;

v) Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale për rastet me të mitur dëshmitar dhe viktima të veprës penale;

vi) Ashpërsim të masave të sigurimit dhe

masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të të fëmijëve;

vii) Hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

viii) Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve me fokus specializimin dhe krijimin e profesionistëve që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ai ndërkombëtarë ndërmjet agjencive ligjzbatuese ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj grupeve të strukturuar kriminale dhe është premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së organit të prokurorisë lidhur me hetimin dhe goditjen e kriminalitetit.

Problematikat dhe rekomandimet e paraqitura nga institucionet që kanë në varësi struktura që kanë statusin e oficerëve të policisë gjyqësore lidhen me forcimin e bashkëpunimit dhe përfshirjen e oficerëve në hetimin e çështjeve ose në grupe hetimore të përbashkëta veçanërisht në çështjet komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinimin me prokurorinë në funksion të rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve që kryhen prej tyre.

Nga statistikat e prokurorisë për vitin 2018 konstatohet se numri më i madh i referimeve ka ardhur nga policia e shtetit me 36511 çështje të referuara, ndërkohë që referimet e policive të tjera janë si vijon: 36 çështje të referuara nga policia elektrike; 19 çështje të referuara nga policia pyjore; 20 çështje të referuara nga policia elektrike dhe 249 çështje të referuara nga policitë e tjera. përveç referimeve nga policia e shtetit, numri i referime të tjera vijon të jetë i ulët, edhe pse konstatohet një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2017⁷⁰.

Bashkëpunimi i organeve të hetimit jo vetëm me oficerët e policisë gjyqësore dhe përfshirja e

⁶⁸ Për vitin 2017 janë dërguar për gjykim 12997 çështje, për 1241 prej të cilave është kërkuar gjykim i drejtpërdrejtë.

⁶⁹ Në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 11790 çështje.

⁷⁰ Të dhënat për vitin 2017 kanë qenë: 35676 referime nga policia e shtetit; 19 referime nga policia financiare; 48 referime nga policia pyjore; 29 referime nga policia e ndërimit; 7 referime nga policia elektrike dhe 149 referime nga policitë e tjera.



tyre në hetim me qëllim efektivitetin e burimeve njerëzore, sjellë jo vetëm hetime të plota dhe të gjithanshme, por dhe finalizim me sukses të çështjeve të regjistruara, duke shmangur referimet fiktive dhe hetime të dështuara me pasojë moshetimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të elementëve të rrezikshëm kriminalë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional, nga organi i prokurorisë rezultojnë:

i) Është bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme duke dhënë kontribut në hartimin e planeve të veprimit të dokumenteve strategjike; **ii)** Me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është koordinuar puna në kuadër të raportimit të historikut të çështjeve penale që lidhen me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve vendor; **iii)** Prokuroria e Përgjithshme ka marrë pjesë në grupe pune në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për projektligjin “Për shtesa e ndryshime në Kodin Penal” lidhur me veprat penale në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e bimëve, kafshëve dhe mjedisit, në projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” lidhur me regjimin e posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë, si dhe projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”; grupe pune me Ministrinë e Drejtësisë për amendimin e rregullave mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale në ligjin nr.10193 datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”; grup pune me Ministrinë për Evropën

dhe Punët e Jashtme, për hartimin e projektligjit “Për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare”; **iv)** në kuadrin e unifikimit të qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V ka ngritur një grupe pune për rishikimin dhe përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të prokurorive, për unifikimin dhe përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale të prokurorisë në të gjitha hallkat dhe nivelet e juridiksionit të përgjithshëm; **v)** Sa i përket bashkëpunimit në funksion të hetimeve të shpejta dhe forcimit të masave ndëshkuese nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit, gjatë vitit 2018 drejtuesit e prokurorive në kuadrin e bashkëpunimit me drejtues të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave kanë bërë përpjekje për të zbardhur faktet penale në fushën e mjedisit dhe parandalimin e dëmtimeve në mjedis. Të dhënat statistikore në vitin 2018 për grup veprat penale kundër mjedisit, evidentojnë se, ka tregues në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara në masën prej 14,35% krahasuar me vitin 2017, ashtu dhe është rritur numri i procedimeve të dërguara në gjykatë në masën prej 73,33% krahasuar me vitin 2017. Gjithashtu, të dhënat lidhur me të pandehurit për këtë grup veprash penale të krahasuara me vitin 2017 evidentojnë tregues në rritje prej 54,64% e numrit të pandehurve të regjistruar, rritje prej 82% e numrit të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe rritje rreth 2, 3 herë e numrit të pandehurve të dënuar nga gjykata.

Ministritë e linjës që kanë në kompetencë agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, informojnë për bashkëpunimin me organin e prokurorisë duke referuar praktikatat e mira pozitive por edhe problematikatat :

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit⁷¹ bën me

⁷¹ Me shkresën e saj nr. 1684/1 prot., datë 21.3.2019, regjistruar me tonën me nr. 1466/6 prot., datë 26.3.2019 informon se, për vitin 2018 ka depozituar në organin e prokurorisë 95 kallëzime penale për vepra penale që lidhen me mjedisin. Rezultojnë se për 24 kallëzime prokuroria ka vendosur



dije se nga 95 materiale referuese të ISHMPU-së vetëm 4 prej tyre janë dërguar për gjykim, duke pësuar rënie krahasuar me vitin 2017. Argumentimi i paraqitur në vendimmarrjen ka qenë mungesa e elementëve të një vepre penale, duke mos përmbushur elementët thelbësorë të vendosura nga ligji, si kusht për t'u konsideruar e tillë. Në këto raste, vendimmarrja është përjashtuar nga fusha e zbatimit të ligjit penal, duke e cilësuar shkeljen si kundërvajtje administrative, dhe jo si vepër apo kundërvajtje penale (shkelje kjo e pa specifikuar, duke mos u referuar te ligji i posaçëm për kundërvajtjet administrative). Është rekomanduar: i) Forcimi i bashkëpunimit me strukturat në nivel qendror dhe rajonal të ISHMU-së me prokuroritë, për rritjen e cilësisë së hetimit dhe referimin e saktë të veprës penale, mbledhjen e provave dhe evidentimin e përgjegjësive penale; ii) Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta midis inspektorëve të ISHMU-së në nivel qendror/rajonal dhe prokurorëve të rretheve gjyqësore; iii) Forcimi i masave ndëshkuese nga prokuroria për kundërvajtjet penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit apo përbërësve të tij të veçantë.

E njëjta situatë rezulton edhe nga analiza e të dhënave statistikore të organit të prokurorisë. Për vitin 2018 për veprat penale të drejtuara ndaj mjedisit (nenet 201–207 të K.Penal), janë regjistruar vetëm 247 çështje, ose 31 çështje më tepër se viti 2017. Nga këto çështje vetëm 78 ose rreth 23% e numrit të çështjeve janë dërguar për gjykim me një numër prej 102 të pandehurish, shifra më të larta se të vitit 2017⁷². Pavarësisht se për këto vepra për vitin 2018 është rekomanduar hetime të shpejta dhe ashpërsim të dënimit, rritja e numrit të çështjeve mbetet e papërfillshme në tërësinë e veprave penale.

Ministria e Brendshme⁷³, lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional bën me dije se në kuadër të identifikimit, gjurmimit dhe hetimit të anëtarëve të grupeve kriminale dhe të aseteve të

tyre është e nevojshme :i) Koordinimi ndërinstitucional me qëllim parandalimin e aktiviteteve kriminale të organizuara dhe forcimi i bashkëpunimit midis Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit, dhe institucionet e tjera ligjzbatuese në funksion të kryerjes së hetimeve të thelluara; ii) me qëllim rritjen e numrit të hetimeve të suksesshme, numrit dhe vlerave të sekuestrimeve dhe konfiskimeve sugjerohet ngritja e grupeve hetimore të përbashkëta, dokumentuar me urdhra delegimi për përfaqësuesit e institucioneve përkatëse; iii) Zhvillimi i hetimeve financiare cilësore gjatë procedimeve penale, me fokus dobësimin e financave të rrjeteve kriminale dhe terrorizmit nëpërmjet shënjestrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga veprimtaritë kriminale, iv) Rritje e cilësisë së hetimeve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhur me rastet e organizatave apo grupeve të strukturuar kriminale, duke i dhënë prioritetet metodave speciale të hetimit dhe koordinimit me hetime të plota financiare, veçanërisht në rastet e transaksioneve financiare të lidhura me vendet e Amerikës Latine.

Lidhur me çështjet e hetimit të korrupsionit, Ministria e Brendshme bën me dije se është e nevojshme: i) përmirësimi i cilësisë së hetimeve, që përfshijnë zyrtarët e lartë publikë, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe duke kryer hetime të plota financiare brenda dhe jashtë vendit; ii) kryerjen e hetimeve sistematike pasurore me qëllim rritjen e numrit të aseteve të sekuestruara në rastet e korrupsionit, në fazën fillestare të hetimit, si dhe konfiskimin e tyre; iii) në kuadër të forcimit të kapaciteteve profesionale, zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta polici-prokurori, si dhe SHÇBA-prokurori, edhe me asistencë të partnerëve ndërkombëtarë, në drejtim të teknikave speciale dhe hetimeve komplekse për krimet financiare, krimet kibernetike dhe ndryshimet e reja ligjore; si dhe iv) kryerja e analizave periodike mbi ecurinë dhe konkluzionet e hetimeve, me qëllim analizimin e mangësive të konstatuara, evidentimin e praktikave më të mira, adresimin e problematikave të hasura, si dhe krijimi i skuadrave të përbashkëta hetimore, me pjesëmarrjen e oficerëve të shërbimit të policisë gjyqësore dhe seksioneve të policisë gjyqësore, të specializuara në tipologji të veçanta krimesh.

mosfillimin, pezullimin, pushimin e hetimeve dhe vetëm për 4 prej tyre është vendosur dërgimi në gjyq, 67 kallëzime kanë qenë në proces.

⁷² Në vitin 2017 janë dërguar për gjykim 45 çështje me 56 të pandehur.

⁷³ Me shkresën e saj nr. 1363/2, datë 5.3.2019, regjistruar me tonën nr. 2155 prot., datë 6.3.2019.



Ministria e Financave dhe Ekonomisë⁷⁴, lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional sugjeron: i) forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit me qëllim shkëmbimin e të dhënave në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit të palicencuara në republikën e Shqipërisë, me qëllim forcimin e luftës kundër informalitetit në tregun e lojërave të fatit; ii) forcimi i bashkëpunimit të oficerëve të policisë gjyqësore të doganave me prokuroritë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe pjesëmarrja e tyre në grupe të përbashkëta hetimore dhe veprime proaktive dhe përfshirja e tyre në rastet kur referimi është kryer prej tyre; iii) rritje e numrit të rasteve që lidhen me nenin 287 të K.Penal, të cilat dërgohen për gjykim, i cili vijon të mbetet i ulët. Duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e lëna nga MONEYVAL, është e nevojshme një analizë e thelluar nga prokuroria në lidhje me hetimin financiar, financimin e terrorizmit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar; si dhe një angazhim më intensiv dhe profesional nga ana e prokurorisë; iv) rritje të numrit të aseteve të konfiskuara në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, duke rritur vëmendjen lidhur me mënyrën e trajtimit të rasteve dhe kërkesat për heqjen e sekuestros; v) rakordim i statistikave midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë në fushat e dënimeve, konfiskimeve, sekuestrimeve dhe letërporosive, për të provuar efektivitetin gjatë raportimit në Komitetin e MONEYVAL; vi) Forcimi i bashkëpunimit midis prokurorisë dhe AAPSK-së me qëllim menaxhimin e pasurive që i nënshtrohen sekuestrimit/konfiskimit, veçanërisht për raste specifike, përshejtim i procesit të dorëzimit të pasurive të sekuestruara/konfiskuara me qëllim zbatimit efektiv të ligjit, detajimin e pjesëve të pasurisë dhe shpenzimeve për administrim.

Ministria e Mbrojtjes⁷⁵ vlerëson bashkëpunimin ndërinstitucional me Prokurorinë dhe shpreh gatishmërinë për vijimin e forcimit të bashkëpunimit midis tyre lidhur me veprat

penale të referuara gjatë fazës së hetimeve të këtyre veprave.

Një problematikë e veçantë është paraqitur nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve⁷⁶, konkretisht në lidhje me referimet e paraqitura prej saj në prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilat për 20 çështje është vendosur mosfillimi i procedimit penal në 6 çështje është vendosur pushimi i procedimit penal dhe në 8 çështje është vendosur pezullimi i procedimit penal. Pavarësisht se në disa prej këtyre rasteve SHKBB-ja ka paraqitur ankim në gjykatë ndaj vendimeve, në kushtet kur ky subjekt referon veprat penale në cilësinë e policisë gjyqësore nuk është legjitimuar për të paraqitur ankim.

Në Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018, i është rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm rritja e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre, ndaj në kuadër dhe të informacionit të paraqitur nga SHKBB-ja sugjerohet: i) përfshirja e oficerëve të policisë gjyqësore të cilët kanë bërë referimin me qëllim evidentimin e saktë të veprave penale dhe dallimin nga shkeljet administrative; si dhe ii) forcimin e bashkëpunimit me qëllim vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve dhe zhvillimin e një hetimi efikas.

Sa më sipër, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Rritjen e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në funksion të përmirësimit të cilësisë së veprimeve hetimore sidomos të metodave speciale të hetimit dhe identifikimit dhe sekuestrimit të aseteve kriminale lidhur me veprat penale të terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, lëndëve narkotike dhe krimeve të tjera të rënda me ndikim të lartë shoqëror;

ii) Forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të

⁷⁴ Me shkresën e tyre nr. 2710/7, datë 25.3.2019 ku është përcjellë kontributi në fushën e mbikëqyrjes së lojërave të fatit, fushën e doganave dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara; si dhe shkresa nr. 243/1, datë 21.2.2019 e DPPPP-së, regjistruar me tonën me nr. 1466/3 prot., datë 22.2.2019.

⁷⁵ Me shkresën e tyre nr. 1350/2 prot., datë 20.3.2019, regjistruar me tonën nr. 1466/4 prot., datë 21.3.2019.

⁷⁶ Me shkresën e tyre nr. 159 prot., datë 31.1.2019, regjistruar me tonë nr. 969 prot., datë 31.1.2019.



hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit;

iii) Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore dhe agjencitë ligjzbatuese vendase dhe të huaja në drejtim të përmirësimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

iv) Trajnime të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore me fokus rritjen e kapaciteteve profesionale të këtyre të fundit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave veçanërisht në rastet e hetimeve të krimit të organizuar, korrupsionit, hetimeve financiare, evazionit fiskal; krimit kibernetik;

v) Forcim të koordinimit ndërinstytucional në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit.

VENDIM

Nr. 297, datë 10.5.2019

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
DREJTËSISË TE AGJENCIA
SHTETËRORE E KADASTRËS (ASHK)
DHE AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), TË PASURISË
NR. 25/2, ZONA KADASTRALE 8525,
ELBASAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 1292, DATË 24.9.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË TË TROJEVE DHE
NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË
RRETHEVE GJYQËSORE DHE
GJYKATAVE TË APELIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të pronës me numër pasurie 25/2, zona kadastrale 8525, me emërtimin “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan”, me vendndodhje në lagjen “5 Maji”, Elbasan, sipas të dhënave të kartelës së pasurisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi, nga Ministria e Drejtësisë, përkatësisht, tek:

a) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), për Drejtorinë Rajonale Elbasan, kati i parë (teknik), kati i dytë (teknik) dhe një sipërfaqe prej 451 (katërqind e pesëdhjetë e një) m² e katit përdhe, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), sipërfaqja prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) m² e katit përdhe, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në listën bashkëlidhur vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar, të hiqet prona me nr. pasurie 25/2, zona kadastrale 8525, me emërtimin “Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Elbasan”.

3. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: shteti

Bashkia/komuna: Elbasan

Fusha e përdorimit të pronës: Për ushtrimin e veprimtarisë administrative

Nr. rend.	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m2)	Nga sip. totale: sa ndërtesë (m2)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera Shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	ZK 8525 El-L-9	25/2	Truall/ ndërtesë	Gjykata e Rrethit L.”5 Maji”	1460	773.45	Për ushtrimin e veprimtarisë administrative	Ministria e Drejtësisë	ASHK ADISA	Ndërtesa ka 3 kate, nga të cilat: Kati përdhe është në përdorim të ADISA-s (250 m ²) dhe ASHK (451 m ²); Katin e parë (teknik) dhe Kati i dytë (teknik) është në përdorim të ASHK-së.



Miratur nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 20, Fq. 148

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol. _____, Fq. _____

Zona Kadastrale: 8525 NR. i PASURISE: 25/2 Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____-->

Indeksi i Hartës: ELI.L.9

PERFUNDIMTARE (data): / /

Adresa e pasurisë: Rrethi ELBASAN Q/F ELBASAN

Rr/L "S MAJ" P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N.: Jo --> Po, Ref: _____

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. <u>1460</u> m ² Ref <u>005868</u>	1. <u>1460</u> m ² Ref <u>005868</u>	1. <u>773.45</u> m ² Ref <u>005868</u>
2. _____ m ² Ref _____	2. _____ m ² Ref _____	2. _____ m ² Ref _____
3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____
4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes:

_____ %

Nr. i Pasurisë (Pallat):

Vol. _____ Fq. _____


Përshkrim i Veçantë
 SIP, NDERTESE (TRE KAT) = 773.45 m²
 SIP, NDERTESE NJE KAT = 40.5 m²
 KATI PERDHE DHE KATI I PARE
 POSEDOHEN NGA GJYKATA E RRETHIT
 GJYQESORE E ELBASAN.
 KATI I DYTE POSEDOHET NGA ANTIKORPORAT
 E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN.
 NDERTESA NJE KAT, VENDROJA DHE
 GARAZHI POSEDOHEN NGA GJYKATA
 E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN.

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
<u>05868</u>	<u>30.08.2019</u>	<u>REPUBLIKA E SHQIPERISE NE PERGJEGJESI ADMINISTRIM TE MINISTRISE SE DREJTESISE</u>		<u>I</u>	<u>ELBASAN</u>			<u>NE BAZE TE V.K.M NR. 1282 DT: 24.09.2008</u>	

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)




 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTERIA E DRJËTËSISË
 Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
 Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive Elbasan

V E R T E T I M
 NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vertetohet se ne regjistrin hipotekor me nr 8525-25 date 30/08/2010 figuron e regjistruar ne pronesi te :

Emri	Atesia	Mbiemri	Pjesa
REPUBLIKA E SHQIPËRISË			NJE SIPERFAQE
NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE			TRUALLI ME
MINISTRISE SE DRJËTËSISË			NDERTEJAT
GJYKATA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN			PERKATESE
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN			

Pasuria me numer 25/2 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8525

me siperfaqe TR. 1460 m², ne adresen LAGJA "5 MAJ",
 NGA KU SIP. NDERTESE (TRE KATI)=773.45m² DHE SIP. NDERTESE NJE KAT=40.5m²
 KATI PERDHE DHE KATI I PARE POSEDDHENGA GJYKATA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN

KATI DYTE POSEDDHEJ NGA TKOMUNIMI E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN
 NDERTEJAT NJE KAT VENDKODJA DHE GARAZHI POSEDDHEN NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN

Kufizimet e pasurise jane:

V. 25/1, L. 25/83, 25/8, 25/16

J. 25/8, 25/16, 25/11, P. 25/1

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajtshme:

Nr.hip. -, date: / / Nr.hip. -, date: / /

Nr.hip. -, date: / / Nr.hip. -, date: / /

Nr.hip. -, date: / / Nr.hip. -, date: / /

Barre mbi pasurine : S' KA

Komente nga regjistruesi: LESHOHET NE BAZE TE V. K. M

NR. 1292 DT: 24.09.2008

Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harte Treguese te Regjistrimit Provizore.

Ky formular miratohet per vertetimin e pronesise deri ne perfundimin e Regjistrimit Fillestar sipas Ligjit Nr. 7843 date 13/07/1994

Vetimi i pronesise leshohet sipas kerkeses Nr. 82,
 Date: 26/08/2010 pasatim ne ZRPP

Date : 108/2010

00005868
 REGJISTRUESI
 Klevis KOSOVA




HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8525 NR.PASURISE 25/2 VOL.20 FQ.148 INDEKSI I HARTES EL: L-9 SHKALLA 1:500 ADRESA E PASURISE: RRETHI ELBASAN Q/F ELBASAN Rr/L " 5 MAJ " P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____		
ELBASAN	<table border="0"> <tr> <td data-bbox="703 580 997 750"> B. KUFIZIMET V. 25/1 L. 25/83,25/8,25/16 J. 25/8,25/16,25/11 P. 25/1 D.DATA 27/08/2010 ORA.10 </td> <td data-bbox="1018 580 1370 750"> C. PRONARI REPUBLIKA E SHQIPERISE Ne Pergjegjesi Administrimi MINISTERIA E DRETTESISE Gjykata e Rrethit Gjyqesore Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Elbasan </td> </tr> </table>	B. KUFIZIMET V. 25/1 L. 25/83,25/8,25/16 J. 25/8,25/16,25/11 P. 25/1 D.DATA 27/08/2010 ORA.10	C. PRONARI REPUBLIKA E SHQIPERISE Ne Pergjegjesi Administrimi MINISTERIA E DRETTESISE Gjykata e Rrethit Gjyqesore Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Elbasan
B. KUFIZIMET V. 25/1 L. 25/83,25/8,25/16 J. 25/8,25/16,25/11 P. 25/1 D.DATA 27/08/2010 ORA.10	C. PRONARI REPUBLIKA E SHQIPERISE Ne Pergjegjesi Administrimi MINISTERIA E DRETTESISE Gjykata e Rrethit Gjyqesore Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Elbasan		
KATI PERDHE DHE KATI I PARE POSEDOHEN NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN KATI DYTE POSEDOHET NGA PROKURORIA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN NDERTESE AT NJE KAT VENDROJA DHE GARAZHI POSEDOHEN NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQESORE ELBASAN			
SIPERFAQJA E TRUALLIT=1460m ² NGA KY NDERTESE(TRE KAT)=773.45m ² NDERTESE NJE KAT=(36.5+4)=40.5m ²			
ING: M.TOILA			



PLAN RILEVIMI

PERGATITI

EMRI Ferdinand Saraci

Licenca nr V 0232

Data e përgatitjes

vula

IDENTIFIKIMI PASURISE

ZONA KADASTRALE 8525

NR.PASURISE " A " VOL... FQ..


INDEKSI I HARTES EL L-9

SHKALLA 1-500

Q/F Elbasan L. "5 MAJ "

P/G Rr. "28 NENTORI "

PRONARI GJYKATA ELBASAN




A .SIPEFAQE TRUALLI 1396.60 M2

SIPEFAQE NDERTESE KATI PERDHE 705,45 M2

SIPEFAQE NDERTESE KATI PARE 679.60 M2 PRONARI (Firma)



PLANIMETRIA KATIT PARE
SH.1 : 200



SIPERFAQE NDERTIMI KATI 721.09M2

ing. Faraci

PLANIMETRIA KATIT PARE	GJYKATA RRETHIT GJYQESOR ELBASAN	FLETA NR 2	PRILL 2007
------------------------	----------------------------------	------------	------------



VENDIM

Nr. 298, datë 10.5.2019

PËR NJË SHITESË FONDI, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHETIT PËR SISTEMIN E DREJTËSISË, MIRATUAR PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatës së Lartë, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në zërin “Shpenzime personeli”, i shtohet fondi, prej 9 929 904 (nëntë milionë e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e katër) lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të personelit mbështetës të caktuar pranë tij nga Gjykata e Lartë.

2. Gjykatës së Lartë, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në zërin “Shpenzime operative”, i shtohet fondi, prej 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekësh, për shpërblimin e ekspertëve dhe shpenzimet e tjera operative të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. Efekti financiar, prej 13 229 904 (trembëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e katër) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1 janar 2019.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 299, datë 10.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 994, DATË 9.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, dhe të neneve 24, 30 e 47, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, që përfaqësohet nga firma ose emër, mbiemër, me shkrim dore, i kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, për aktet e lëshuara deri më 15.8.2008, ose nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për AMTP-të e lëshuara, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 57/2012, “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, dhe të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar.

Në rast se në një AMTP janë të pasqyruara emrat e të gjithë anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, konsiderohet i identifikuar organi që e ka lëshuar AMTP-në, edhe nëse nuk është pasqyruar nënshkrimi i kryetarit, por kanë nënshkruar shumica e anëtarëve të komisionit.



Për formatet e AMTP-ve, ku parashikohet vetëm firma ose nënshkrimi i kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, por kjo firmë mungon, do të konsiderohet i identifikuar organi që e ka lëshuar atë, vetëm nëse vërtetohet me dokumentacion të lëshuar nga DAMT të tillë, si: procesverbale të marrjes së këtyre AMTP-ve në dorëzim nga DAMT-ja apo të dorëzimit të tyre në ish-ZRPP nga kjo e fundit.”.

2. Shkronja “b”, e pikës 2.2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kur gjatë verifikimit rezulton se AMTP-ja, me anë të cilës është kryer regjistrimi, ka mangësi, konstatimet e kryera nga punonjësit që përpunojnë praktikat i referohen me shkrim drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së, duke treguar hollësisht mangësitë e konstatuara.

Regjistrimi në origjinë (fillestar) i tokës bujqësore me AMTP-në është me mangësi në rastet, si më poshtë vijon:

i. kur në AMTP mungon një apo më shumë elemente të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

ii. kur AMTP-ja është me korrigjime të shënimi pronësi apo përdorim (në rastet kur AMTP-ja është lëshuar për territoret e ish-NB-ve), të numri i ngastrës, ose të sipërfaqja dhe emërtimi i ngastrës.

Nuk do të konsiderohen mangësi rastet kur në Drejtorinë Vendore të ASHK-së është i depozituar dokumenti i fitimit të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP) për territoret e ish-kooperativave bujqësore dhe në të konstatohet se fjalët “në pronësi” janë shkruar me shkrim dore mbi fjalët “në përdorim”, të fshirë me vizë. Mbi shënimin me shkrim dore duhet të jetë firma dhe/ose vula zyrtare e ish-komunës.

Në rastin kur dokumentacioni i pronësisë së fshatit, i depozituar në Drejtorinë Vendore të ASHK-së, është i shoqëruar me deklarin e anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, se ky veprim është bërë në mungesë të formularëve të pronësisë, procedohet me regjistrimin. Në të kundërt, Drejtorja Vendore e ASHK-së i drejtohet zyrtarisht bashkisë që të konfirmojë nëse AMTP-ja është lëshuar nga

komisioni i ndarjes së tokës së fshatit. Bashkia, pas verifikimit të dokumentacionit që disponon dhe pas verifikimit faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore, i përgjigjet zyrtarisht Drejtorisë Vendore të ASHK-së. Ky konfirmim, dërguar me shkresë zyrtare nga bashkia, nuk ka të bëjë me konfirmimin e përmbajtjes së AMTP-së;

iii. kur AMTP-ja nuk administrohet në Drejtorinë Vendore të ASHK-së ose administrohet fotokopje, fotokopje e noterizuar apo me shënimin “dublikatë”;

